



# 2014

## RAPORT- TM<sub>2</sub> -2014



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

[www.hidroregjioni-jugor.com](http://www.hidroregjioni-jugor.com)


<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>2</b>
<b>Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”</b>	<b>4</b>
<b>I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME</b>	<b>5</b>
<b>II. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK</b>	<b>6</b>
2.1 Aktivitetet – Prill-Qershor 2014	6
2.2 Prodhimi i ujit m <sup>3</sup>	8
2.3 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	8
2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim	9
2.5 Servisimi I ujëmatësave	11
2.6 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	12
<b>III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË</b>	<b>16</b>
3.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	16
3.2 Aktivitetet e shërbimit për informim	17
3.3 Pengesat në realizimin e objektivave	20
3.4 Planet për të ardhmen	20
<b>IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV</b>	<b>21</b>
4.1.1 Aktivitetet - Prill-Qershor 2014	21
4.1.2 Përgjigje në padi apo revizion	24
4.1.3 Padi nga Kompania	25
4.1.4 Kërkesë e gjykatës themelore për ekzekutim	25
4.1.5 Vendimet në favor të kompanisë	25
4.1.6 Lëndë të kryera përfundimisht	25
4.1.7 Në pritje të vendimeve gjyqësore	25
4.1.8 Procedimi I lendeve ne gjykata per kundervajtje	26
4.1.9 Masat e ndermarra nga Gjykata per kundervajtje	27
4.1.10 Procedurat gjyqësore te pambaruara	27
4.1.11 Vendimet e leshuara për ankesat e konsumatoreve	28
4.2 Aktivitetet e zyrës së Teknologjisë Informative	28

---

<b>V.</b>	<b>RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR</b>	<b>29</b>
5.1	Aktivitetet - Prill-Qershor 2014	29
5.2	Shpenzimet – Prill-Qershor 2014	29
5.3	Raport I performances- Janar- Mars - Prill-Qershor 2014	29
<b>VI.</b>	<b>RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM</b>	<b>45</b>
<b>VII.</b>	<b>RAPORT I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT</b>	<b>47</b>
<b>ORGANOGRAMI</b>		

---

## ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



## I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME

### FURNIZIMI

Edhe pse prurjet e ujit në burimet e vjetra me gravitet kanë filluar të kenë rritje nga të reshurat e fundit, por kemi edhe shtim të kapaciteteve të reja të ujit përmes shpimeve të puseve, kemi arritur të kemi gjendje të qëndrueshme të furnizimit me ujë për të gjithë qytetin e Prizrenit.

Kompania është angazhuar dhe ja ka arritur që në TM-2 të vitit 2014 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku dhe kemi reduktime brenda ditës (*Kryesisht Lagja Dardania dhe në disa lagje tjera të qytetit*).

Në Njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka pas probleme me furnizim me ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e Njërive Operuese kemi pas furnizim të rregullt me ujë të pijes.

### UJI I PRODHUAR

Për TM2 2014 në nivel regional janë raportuar prodhim të ujit **4,290,122.00 m<sup>3</sup>**, krahasuar me TM-1 kemi një rritje të prodhimit të ujit të pijes prej **94,105.00 m<sup>3</sup> (2.24%)**. Janë duke vazhduar aktivitetet për mbajtje gjendjen stabile të furnizimit me ujë.

### FATURIMI

Në periudhën e TM2 - 2014 janë faturuar 1,738,033 m<sup>3</sup>, apo 5.05% më shumë se në TM1-2014

Faturimi në Euro në TM2- 2014 ka qenë 986,886.21.45€, në krahasim me TM1 -2014 ka pas një rritje prej 5.36%

### INKASIMI

Në periudhën e TM2 -2014 janë inkasuar 584,230.64€, apo 7.88% më pakë shumë se në periudhën TM1 -2014.

Përqindja e inkasimit ishte 68.57% ose 10.67% më e ulët se në periudhën TM1 - 2014

### UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfidë kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falënderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar shumë aktivitete kryesisht në zvogëlimin e UPF-se.

Kompania në nivel regional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPF-se që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohe të defekteve në tërësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë lektorët e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e tyre sa më të shpejtë. Kompania është duke i vazhduar aktivitetet për zvogëlimin e UPF-se dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Është formuar grupi i veçantë brenda Departamentit Teknik për verifikimin e rrjetit shpërndarës dhe verifikimin e valvuleve në qytetin e Prizrenit.

Raportet tregojnë që UPF në nivel regional për TM-2 është **59.49%** ose **- 1.08%** me **zvoglim** të UPF nga TM-1.

**SHPENZIMET**

Shpenzimet në periudhën e TM2- 2014 rrinë në 713,925.81 € apo 10.53% më të ulëta se në periudhën TM1 -2014. Në këtë kanë ndikuar sidomos shpenzimet e energjisë elektrike me – 42.33%

**MBULIMI OPERATIV**

Mbulimi operativ për periudhën TM2 - 2014 ishte 0.96 , me një përmirësim prej 0.03 në krahasim prej TM1- 2014

**II. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK****2.1 Aktivitetet - Prill - Qershor – 2014**

\*Aktivitetet e shërbimit Teknik ne nivel regional kanë qene te pareshtura dhe janë orientuar ne mundësinë e furnizimit sa me te rregullt me ujë te pijes për te gjithë konsumatorët qe kjo kompani i mbulon, si dhe në aktivitetet teknike për uljen e humbjeve si atyre teknike po ashtu dhe atyre administrative respektivisht uljen e vlerave të UPF-së.

\*Në njesine punuese te Prizrenit gjatë TM-2 ka pasur aktivitete në ndërhyrjet në rrjetin e ujës-jellësit dhe te kanalizimit: defekte ne rrjetin sekondar dhe primar, pastrimi dhe fryrje te rrjetit me kompresor, kontrollimi i pusetave dhe pastrime te pusetave, kontrollime dhe pastrime te kanalizimit, riparime te rrugëve etj. *(te dhënat ane ne forme tabelare si me poshtë).*

\*Në këtë TM-2 është bërë përrurimi i dy rezervarve ne Baqevëc, investim i realizuar nga Qeveria e R. Kosovës, ku pjesëmarrës në këtë investime është edhe Kuvendi Komunal i Suharekës i cili ka participuar ne shtimin e sasisë se ujit te pijes përmes shpimit te puseve, njëherit në këtë projekt kemi investime edhe nga Kompania jone.

\*Sa i përket projektit pre Grumbullimin dhe trajtimin e ujerave te zeza për qytetin e Prizrenit jemi ne fazën fillestare te implementimit te projektit. Faza e pare e projektit është pothuajse ne fazën përfundimtare te fillimit te punimeve pre momentin jemi ne pritje te KfW-se e cila do ta ape fjalën përfundimtare për kompaninë e cila është fituese e tenderit për realizimin e punimeve.

\*Sa i përket fazës se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me ndërtimin e ITUZ-se, momentalisht ka përfunduar faza parakualifikuese dhe jemi ne pritje te ofertave përfundimtare nga aplikantët te cilët kane kaluar fazën parakualifikuese, data e fundit e dorëzimit te ofertave ne pajtim me KfW-ne është caktuar data 30 Korrik 2014.

\*Sa i përket pjesës se dyte te faze se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me Masat Shoqëruese është përcaktuar Agjenti i Tenderit nga ana e KfW-se dhe ne jepi ne korrespondence te rregullt me te njëjtin,

deri me tani është shpallur tenderi për këtë projekt dhe deri me tani janë dorëzuar ofertat. Agjenti i Tenderit se bashku me komitetin e projektit nga KRU“HRJ“ ka bere evalumin e ofertave ne fazën parakualifikuese janë përcaktuar 5 kompani ne këtë faze dhe jemi ne pritje te miratimit nga Agjenti i tenderit dhe KfW. Deri me tani nde nuk kemi marre miratimin nga KfW, ne momentin e marrjes se miratimit do te njoftohen te gjithë aplikantet si dhe menaxhmenti i kompanisë.

\*Ne ministrinë e Financave është dorëzuar marrëveshja për kanalizimin e mjeteve donacion nga Qeveria Federale Gjermane për projektin e ujerave te zeza, Marrëveshja e pare ka te beje me shumën prej 4 milion Euro kurse marrëveshja e dyte për shumën prej 8 milion euro, këto marrëveshje janë dorëzuar ne ministrinë e financave dhe janë nënshkruar nga Ministri i Financave. Sa i përket marrëveshjes për Eficiencen e Energjisë Elektrike edhe kjo marrëveshje është draftuar nga ministria e financave është nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe jemi ne pritje te nënshkrimit nga ministri i Financave, këto marrëveshje janë kusht për procedimin e memtutjeshem te projektit.

\*Kohë më parë ka filluar projekti i financuar nga komuna e Prizrenit „Sheshi i Lidhjes“ projekt ky i cili parasheh vendosjen e një gypi transportues te ujit Ø 400mm dhe Ø 125mm si dhe projektin e ujerave fekale sipas projektit te perpiluar nga zyra e konsulences, punimet janë në përfundim. Inxhinieret e konsulences dhe kompanisë kane dale disa here ne mbikëqyrje te punimeve, me ç rast dhe kemi konstatuar se punimet janë realizuar sipas **paramases** se dhëne nga konsulenca. Ne banesën afër zyrave te Partisë Turke është raportuar një ankese nga banoret ku është konstatuar interferenca e ujerave te zeza ne bodrumin e kësaj banese, inxhinieret se bashku me operativen kanë dake ne vendin e ngjarjes për ende nuk kanë mundur te konstatojnë infiltrimin e ujerave te zeza se nga ka munde te infiltrohet, Operativa ka dale ne vendngjarje dhe përmes pompës ka provuar te konstatoje infiltrimin por ende nuk është konstatuar, është njoftuar kompania pune kryese dhe komuna e Prizrenit përmes nje shkrese elektronike nga menaxheri Teknik se ne rast te konstatimit te mundshme do te përgjigjen konform konstatimit.

\*Takime te vazhdueshme me CDI-ne per projektet qe do te financohen nga qeveria Zvicerane dhe R. e Kosovës, ne këtë takim është diskutuar lista e projekteve për te gjitha komunat ku operon HRJ, me ç`rast dhe është bere ndarja e projekteve për rehabilitimin e sistemeve ekzistuese dhe ndërtimi i sistemeve te reja te ujësjellësit, ne theks te veçante ne fazën e pare do te investohen vetëm ato fshatra te cilat nuk janë nen menaxhimin e HRJ-ne,

\*Vizite ne teren neper punishtet ku janë duke u zhvilluar punime me ç`rast dhe është bere inspektimi i punimeve nga inxhinieret e kompanisë. Momentalisht jemi duke i zhvilluar projektet e investuara nga MZHE, dhe kemi raportuar konform kërkesave te MZHE-se.

\*Kohe me pare kanë filluar punimet ne rrugën „Fetah Gega“, gjatë kësaj periudhe janë përfunduar punimet siç janë te parapara me kontrate, si dhe kanë zhvilluar punimet ne Rr. „Kadri Nesho“ ku janë realizuar ne tersi punimet si dhe është bere pranimi teknik i punimeve. Projekt ky i investuar nga Qeveria e Kosovës, kompania fituese është Fanaj Engineering dhe kanë përfunduar punimet ne kohen e paraparë. Dokumentacioni është dorëzuar ne MZHE.

\*Ka përfunduar edhe pjesa e dyte e projektit te investuar nga MZHE Hapja e puseve te livadhet, me ç`rast dhe është dorëzuar komplet dokumentacioni ne MZHE.

\*Takim me grupin punues te këshillit ndërministror te qeverise ne objektet e Qeverise, me ç`rast është përgatitur ne forme te shtypur dhe elektronike zonat e burimeve te KRU“HRJ“ ne nivel regjional, ne këtë

takim është diskutuar mundësia e zbatimit të udhëzimit administrativ 16/2012 për monitorimin e cilësisë së ujit, në takim morën pjesë Lulzim Pacarizi dhe Nexhmedin Shala.

\*Në çdo muajin janë bërë leximet e ujëmatësve zonal me qëllim për të verifikuar harxhimet e ujit neper zonat e veçanta.

\*Aktivitetet e shërbimit teknik të ndermarrura për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale,
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – detektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për detektim.
- ✚ Sensibilizimin e të gjithë konsumatoreve për mos keqpërdorim të ujit të pijes ermes, fletëpalosjeve, informatave mediale dhe atyre të shkruara,
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatoreve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

## 2.2 PRODHIMI I UJIT m<sup>3</sup>, TM-2, 2014

Muaji	Prodhimi mujor m <sup>3</sup>	Prodhimi ditor- m <sup>3</sup>	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,301,510.00	36,280.33	419.9	
Suharekë	544,612.00	5,984.75	69.3	
Dragash	107,678.00	1,183.27	13.7	
Malishevë	336,322.00	3,695.85	42.8	
<b>Total</b>	<b>4,290,122.00</b>	<b>47,144.20</b>	<b>545.7</b>	

## 2.3 MIRËMBAJTJA E RRJETIT – SANIMI I DEFEKTEVE, TM-2, 2014

Njësia Operative	Ujësllësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	267	189	456
Suharekë	126	18	144
Dragash	10	0	10
Malishevë	81	13	94
<b>Total</b>	<b>484</b>	<b>220</b>	<b>704</b>

## 2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim – TM-2, 2014

Për periudhën që po raportojmë në kuadër të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në teren kanë vazhduar bllobimet neper qytetin e Prizrenit për të kryer refreshimin këto kanë arritur këto rezultate.

- Ujëmatës të bllobuar 140 .
- Kontrata të nënshkruar 140.
- Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 559 .



- Konsumatorët që ekipa konstaton që duhet të zëvendësohet ujëmatësi 21.
- Konsumatorët që janë të bllojuar 731.
- Konsumatorët pa ujëmatës 31.
- Rekorde të reja për blockmapping 25.
- Konsumatorët që nuk kanë lidhje uji 17.
- Konsumatorët me puseta të bllojuar 04.
- Ribllozim, bllozim për here të dyte 81.
- Konsumatorët me regjistrim paushall 15.
- Konsumatorët me puse 03.

	Prizren Total –Gjithësej	Total
1	Bllombim-Kontrata	140
2	Dera Mbyllyr (Heren e dyte)	559
3	Ujematesa te bllokuar	04
4	Pa ujemates	31
5	Zavendsime	21
6	Nuk kane lidhje te ujit	17
7	Rekorde te reja per blockmapping	25
8	Me puse	03
9	Bllombim per here te dyte	81
10	Regjistrim paushall	15
11	Bllombimet e me hershme	731

#### AKTIVITETET KRYESORE

##### 1. Aktivitetet në fshatin Murademaj

- Bllombim-Kontrata 49.
- Instalim të ujëmatësve 23.
- Demontim-Montim të ujëmatësve 14.
- Dera Mbyllyr 10.
- Zëvendësime 20.
- Vend i papershtateshem për montim të ujëmatësve 09.
- Konsumatorë me ujëmatës 26.
- Konsumatorë që kërkojnë ç'kyçje 03.
- Rekorde të reja në hartë për Blockmapping 78 rekorde

##### 2. Aktivitetet në fshatin Sopij – Suharekë

- Ujëmatës të bllojuar 224 Ujëmatës.
- Kontrata të nënshkruar 224 Kontrata
- Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 38 konsumator.
- Konsumatorët që nuk kanë lidhje të ujit 112.
- Konsumatorët që kanë lidhje të ujit, mirëpo nuk kanë shërbime 30.
- Konsumatorët pa ujëmatës 39.
- Konsumatorët që duhet të regjistrohen 16.

- Konsumatorët me puseta te bllokuara 03.
- Konsumatorët që nuk pranojnë 01.

### 3. Aktivitetet në fshatin Doberdelan – Suharekë

- Ujëmatësa të bllokuara 169 Ujëmatësa.
- Kontrata të nënshkruara 169 Kontrata
- Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 32 konsumator.
- Konsumatorët që nuk kanë lidhje të ujit 09.
- Konsumatorët që kanë lidhje të ujit, mirpo nuk kanë shërbime 02.
- Konsumatorët që duhet të regjistrohen 04.
- Konsumatorët me puse 59.

### 4. Aktivitetet në fshatin Semetishtë – Suharekë

- Ujëmatës të bllokuara 90 Ujëmatësa.
- Kontrata të nënshkruara 90 Kontrata.
- Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 39 konsumator.
- Konsumatorët që nuk kanë lidhje të ujit 73.
- Konsumator me lidhje uji, por në shërbim jo 04.
- Konsumatorët me puse 21.
- Konsumatorët pa ujëmatës 15.
- Konsumatorët që deklarojnë që janë me puse 17.

### 5. Kontrata-Bllombime në qytetin e Suharekës

- Ujëmatës të bllokuara 180 .
- Kontrata të nënshkruara 180 .
- Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 63 .
- Konsumator me puse 61.
- Konsumator me lidhje uji, por në shërbim jo 03.
- Konsumatorët pa ujëmatës 24.
- Konsumatorët që duhet të regjistrohen 04.
- Konsumatorët që nuk pranojnë 01.

6. Në muajin Prill - Qershor, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë arritur që gjithsej të demontojnë dhe montojnë 355 ujëmatës, ekziston raporti i veçantë.

7. Grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellësit ka bërë gjithsej 126 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 86 defekte, ekziston raporti i veçantë. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 7,027 m.

8. Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësve zonal për këtë muajt Prill-Qershor, ku ujëmatësit zonal në pikat matëse: Jusuf Gervalla, Sheshi i Lidhjes, FSK-ja për arsye të kushteve atmosferike si dhe faktorit njeri nuk kemi arrit me të lexuar, ndërsa në pikën matëse të Ura e Gani Tades e kemi lexuar me datë: 05.05.2014, Sheshi i Lidhjes

(punime në shesh), Fehmi Lladrovci leximi i ujëmatësit është bërë me datë: 07.07.2014 dhe në Vlashne është marrë kapaku i pusetes, pikat tjera janë kontrolluar dhe rezultoi se të gjithë ujëmatësit janë në gjendje të rregullt për muajt Prill-Qershor.

## 2.5 Shërbimi i mirëmbajtjes – servisimi i ujëmatësve – TM-2, 2014

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipen e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit, bënë servisimin dhe kalibrimin ujëmatësve të profileve  $\Phi(13-100)$  mm.

### Prill-Qershor 2014

Njësia Operative	Profili $\Phi$ mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	81	Ujëmat. i riparuar për depon e kompanisë. -10 cope 1/2" , -10 cope 3/4" Ujëmat. Të riparuar për „Radoniqin“ -9 cope 3/4" -Spitali Rajonal Prim.Dr.Daut Mustafa – Riparimi i ujëmat: 2 x $\Phi 100$ dhe 1 x $\Phi 1$ " -„Radoniqi (njës.oper.Rahovec) 40 copa 3/4" -Asambleja komunale –Prizren Pastrimii i ujëmat. $\Phi 50$ -„Ramateks“ $\Phi 100$ dhe 1": Riparim -„Radoniqi (njës.oper.Rahovec) 73 + 2 (konsum.) copa 3/4"
	3/4"	209 + 184	
	1"	26	
	5/4"	1	
	6/4"	0	
	Gjithsejt:	501	
Suharekë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Dragash	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Malishevë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	

## 2.6 ANALIZAT E UJIT TË PIJES- TM-1 DHE - TM2 - 2014

### JANAR-MARS 2014

Muaji	Nr. Total	Biologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk l pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk l pergj.
JANAR	151	108	80	28	43	42	1
SHKURT	124	87	67	20	37	37	0
MARS	147	103	100	3	44	44	0
<b>Total</b>	<b>374</b>	<b>250</b>	<b>247</b>	<b>3</b>	<b>124</b>	<b>123</b>	<b>1</b>
% e Deshtimeve				1.2			0.8
% e Desht. Total							1.1

## PRILL-QERSHOR- 2014

Muaji	Nr. Total	Biologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.
PRILL	165	122	89	33	43	43	0
MAJ	136	94	81	13	42	40	2
QERSHOR	141	99	90	9	42	42	0
<b>Total</b>	<b>442</b>	<b>315</b>	<b>260</b>	<b>55</b>	<b>127</b>	<b>125</b>	<b>2</b>
% e Deshtimeve				<b>17.5</b>			<b>1.6</b>
% e Desht. Total							<b>12.9</b>

## JANAR-QERSHOR- 2014

Muaji	Nr. Total	Biologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.
JANAR	151	108	80	28	43	42	1
SHKURT	124	87	67	20	37	37	0
MARS	147	103	100	3	44	44	0
PRILL	165	122	89	33	43	43	0
MAJ	131	89	81	13	42	40	2
QERSHOR	141	99	90	9	42	42	0
<b>Total</b>	<b>864</b>	<b>613</b>	<b>507</b>	<b>106</b>	<b>251</b>	<b>248</b>	<b>3</b>
% e Deshtimeve				<b>17.3</b>			<b>1.2</b>
% e Desht. Total							<b>12.6</b>

## Prill, 2014

\*Aktivitetet -Kontrolli permanent I klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit në qytet dhe fshatra ;  
Riparimi I injektorit për klor gaz në  $\phi$  400 (në Mulli) si dhe ndërrimi I pjesëve të shkatëruara si pjesë e injektorit që ndërlidhet në system të furnizimit;

\*Pjesëmarrja në mbledhjen e organizuar nga ana e SHUKOS-it në Prishtinë për menagjerët e cilësisë së ujit për të gjitha ujësjellsat Rajonal. Është diskutuar rreth çështjes së parametrave si Kimike ashtu edhe Bakteriologjike për të cilat bëhen matjet në laboratorët përkatëse gjegjësisht definimi I atyre parametrave që analizohen nga ana e ISHP-ëve si dhe definimi I çmimoreve për parametra gjegjëse pqr të cilat do të diskutojnë Kryeshefat Ekzekutiv në SHUKOS. Gjithashtu është bërë fjalë për akreditimet e laboratorëve në kuadër të Ujësjellësive Rajonal. Raporti për këto parametra që duhet të punohen I është dërguar z.Fidaim Jashari, Drejtorit Menagjues të SHUKOS-it si dhe Dr.Burbuqe Nushi, koordinatorë për çështje të ujit në IKSHP-Prishtinë.

\*Vizita disa ditore në Ujësjellësin e Suharekës gjegjësisht në fshatin Sopi, ku ka pasur ankesa nga një Drejtor I shkollës fillore për cilësinë e ujit. Me këto vizita kemi senzibilizuar kontrollin e ujit gjegjësisht futjen e procesit të klorifikimit për këtë fshat ( është vendi shumë I papërshtatshëm për instalimin e ndonjë paisje për klorifikim),kemi modifikuar klorifikimin por, përsëri të themi se pa e bërë ndonjë object për këtë çështje

procesi I klorifikimit nuk do të jetë në nivel të duhur. Të ceku edhe këtë se analizat Fiziko – Kimike I përgjigjen standardeve të ujit të pijes të papërpunuar. Për këtë është njoftuar edhe Kryeshefi Ekzekutiv si dhe Menaxheri I Njësisë Suharekë;

\*Analizat bakteriologjike të bëra nga ana e ISHP-së dhe nga ana jonë në disa pika të furnizimit janë përsëritur disa herë dhe se përqëndrimi kryesor I kontrollit ka qenë mu në këto pika. Është vija e furnizimit që përfshin Tregun e Gjelbërt, ShF.Abdyl Frashëri si dhe disa pika që ndërlidhen me këtë rrjetë.

\*Edhe pse në pikat e lartpërmendura disa analiza të ujit nuk kanë qenë të kënaqshme, në këto pika klori residual ka rezultuar të jetë prej 0.2 – 0.3 mg/l;

\*Koncenrimi i kontrollit të ujit dhe aktiviteteve në këtë muaj ka qenë në burime(puse) të reja si dhe përsëritja e analizave në ato vende (disa herë) ku analizat kanë qenë pozitive.

#### **Maj, 2014**

\*Përcjellja permanente e klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit;

\*Ndërrimi i bomolës 1 t në Mulli. Përsëri gjatë ndërrimit të bomolës me klor kemi pasur shumë vështësi gjatë instalimit për shkak të papastërtisë së klorit gaz ku, me ç'rast vinte deri te zaptimi i gypave të cilat është dashur të pastrohen rishtazi. Është në funksion pas largimit të ndytësirave;

\*Vizita disa ditore në fshatin Billush për aktivizimin e procesit të klorifikimit. Për shkak të terrenit të vështirë kemi pasur vështësi si gjatë instalimit të deponisë për klor të lëngët si dhe përcjelljes së klorifikimit në rrjetë. Është bërë trajnimi i personit që do të kujdeset për procesin e klorifikimit dhe i cili është pajisur me komparator dhe DPD tableta për përcjelljen e klorit residual në pika të ndryshme të furnizimit në fshat.Procesi i tranimit do të vazhdojë përderisa punëtori të parballojë njohuritë elementare për këtë çështje;

\*Vizita disa ditore në fshatin Murademë për aktivizimin e procesit të klorifikimit. Edhe këtu kemi hasur në shumë vështësi për shkak të terrenit të papështatshëm për në rezervoar. Këtu kemi qenë më shumë pasi që shpesh mungon energjia elektrike. Edhe këtu kemi bërë edukimin e punëtorit adekuat që do të përcjelli procesin e klorifikimit gjegjësisht përcjelljen e klorit residual në pika të ndryshme të furnizimit në fshat me anë te komparatorit dhe DPD tableta. Duhet të dërgohen elektrikisti të konstatoje defektin në sinjalizues që dikton furnizimin me ujë për në rezervoar;

\*Vizita e nje delegacioni nga ujësjellësi i Pejës për diskutim rreth çështjes së paisjeve për laborator dhe procesit të akreditimit;

\*Vizita në rezervoarin e ri në Sallagrahdë dhe diskutim rreth mënyrës së vënjës të sistemit të klorifikimit me personin nga Prishtina i cili është autorizuar nga Kryeshefi ekzekutiv për instalimin e kloraprateve;

\*Analizat e bëra nga ana e ISHP-së rezultojnë të jenë prej 73 analizave 7 nuk i përgjigjen standardeve të ujit të pijes, edhe pse përsëri në të gjitha mostrat figuron të jetë klori residual prej 0.2 – 0.3 mg/l.Në Suharekë prej 15 analizave 2 nuk i përgjigjen standardeve të ujit të pijes, në Malishevë prej 5 mostrave 4 nuk i përgjigjen dhe në Dragash prej 5 mostrave të gjitha i përgjigjen.

#### **Qershor.2014**

\*Përcjellja dhe kontrolli I klorit residual në mënyrë permanente në pika të ndryshme të furnizimit;

\*Vizita dy ditore në fshatin Muardem për të rregullua dhe dezinfikuar sitemin e klorifikimit për këtë fshat.Për shkak se kurrë nuk është bërë klorifikimi dhe një kohë të gjatë është dashur të dezinfikohet rezervoari dhe rrjetat. Pasi që është bërë dezinfikimi janë marrë mostrat bakteriologjike para dhe pas dezinfikimit 2x. Klori residual ka rezultuar të jetë 0.3 mg/. Analizat bakteriologjike janë në rregull pas dezinfikimit;

\*Përgaditja e raportit për pika të ndryshme të furnizimit për marrjen e mostrave për të gjitha Njësitë sipas Udhëzimit Administrativ për këtë çështje;

\*Pjesëmarrja në takim në zyret e Ministrisë me Menaxherin Teknik, Lulzim Paçarizi. Pjesëmarrës tjerë kanë qenë Këshilli Ndërmnistror I Ujërave, IKSH, ZRRUK, SHUKOS dhe Menaxherët Teknik dhe Dhe Menaxherët e

cilësisë së ujit të Ujës-jellësve Regjinal për zbatimin e UA 16/20/12 për cilësinë e ujit të pijes. Agjenda e takimit ka qenë Zonat e Furnizimit, Monitorimi I Mbrendshëm, progresi në akreditimin e KRU-ve për monitorimin e cilësisë së ujit(Raport I SHUKOS-it). Jemi dakorduar që raportet për monitorim intern me kalkulime dhe sqarim si dhe hartën e zonave furnizuese të dërgohen Z.Afrim Lajç dhe Dr.Burbuqe Nushi. Këti komplet janë dërguar më vonë;

\*Për shkak të rreshjeve të mëdhaja të gjitha burimet I kemi shkarkuar jashtë pasi që turbiditeti I ujit është rritur shumë.Kjo ka zgjatur një ditë pasi që të nesërmen uji është kthjelluar dhe I kemi futurë në system;

\*Është bërë detektimi I një rrjedhjeje të ujit të pijes në Kurillë, familja Qereti;

\*Analizat bakteriologjike të bëra nga ana e ISHP- Prizren rezultojnë të jenë: Prizren-prej 79 analizave tre (3) nuk I përgjigjen standardeve të ujit të pijes. Këto tre mostra përbajnë sasinë e klorit residual prej 0.2 mg/l. Suhareka – prej 15 mostrave 4 nuk I përgjigjen standardeve të ujit të pijes. Dragashi- prej 5 analizave të gjitha I përgjigjen standardeve të ujit të pijes. Malisheva – prej 5 analizave të gjitha I përgjigjen standardeve të ujit të pijes.

### Raport nga Menaxheri i projekteve

\*Projekti : Programi Mbeshtetes per uje dhe Kanalizim ne zonat Rurale Faza e V-te

\*Investues: Qeveria Zvicrane dhe Qeveria e Kosoves

Implementues: Dorsch Gruppe (Dorsch International Consultants) nga Gjermania dhe CDI(Community development initiatives ) nga kososva (Ekipi I stafit Nderkombetar dhe Vendor )

\*Vlera e pergjithshme e investimeve 14,000.000. Euro , per shtat Kompanit Rajonale te Kososves .

\*Qellimi : Sherbimet publike te Kososves te mbulojn me furnizim te ujit te pijshem pjesen me te madhe te popullsis ne tere vendin dhe te menagjoj sistemin e trajtimit te ujrave te zeza ne pilot projektet .

\*Takimi i pare i grupit punues , Zyret e Hidroregjionit Jugor Prizren

Ne kete takim kan marr pjese Kryetaret e Kuvendeve Komunale ( Prizreni,Suhareka, Dragashi, Malisheva ,Mamusha ), Hidroregjioni jugor. Ne takim u prazentua Program Mbeshtetes per uje dhe Kanalizim ne zonat Rurale ne Kososve - RWSSP-Faza e V-te

\*Programi do te ket disa komponentete :

Komponente e pare - perfitues do te jene fshatrat qe nuk kan fare sitem te ujesjellsit

Komponente e dyte – Fshaterat qe kan sistem te ujesjellsit por kan nevoj te rehabilitoren per te qene plotesisht funksional.

Komponente e trete - Ndertimi i impianteve biologjik per trajtimin e ujrave te zeza ne zonat rurale - pilot projekte

Komponente e katerte - Zona e pare mbrojtese e burimeve ujore

\*Caktimi i Anetareve te Grupit punues

Implementuesit e programit kerkues qe te caktohen nga nje anetar i Kuvendeve Komunal edhe Hidroregjioni Jugor me kompetenca te plota per te marr pjes ne grupin e punes .

Programi Mbeshtetes per uje dhe kanalizim ne Zonat Rurale ne Kososve - Faza e V-te do te jete kater vjeqar.

Takimi i dyte , Zyret e Hidroregjionet Jurgo”, Agjenda ,

\*Prezentimet e projekt propozimeve nga Komuna e Prizrenit, Suharekes, Malisheves, Mamushes dhe Dragashit, Anetaret e Grupit punues;

1.Zenel Zenelaj nga Hidroregjioni Jugor

2.Florim Krasniqi , Drejtor i Urbanizmit - K.K. Dragash

3.Nexhat Ramadani , Drejtor i Sherbimeve Publike - K.K. Suhareke

4/Urimev Kastrati ,Drejtor i Urbanizmit - K. K. Malisheve

5. .... K.K. Prizrenit

6.....K.K.Mamushes

\*Ne kete taim u diskutuan fshatrat te cilat nuk kan fare ujesjelles dhe jene ne prioritet dhe njeherit jene mundesit reale per furnizim me uje , por u mungon sistemi i ujesjellesit.

\*Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe Mamushes nuk kan perzgjedh anetarin e Grupit punues .

Ne takimet e radhes me prioritete eshte komponenta e pare -Fshatrat qe skan fare sistem te ujesjellasit.

\*Detyra ne vijim e grupit punues me implementuesit e projeketit eshte pergaditen projeketet ideore per fshatrat te cilat do te jene ne listen e propozuar per investime .

Faza e pare e aplikimit mbyllet ne gusht Takimet vazhdojn sipas nevojës .

Maj, 2014

\*Projekti : Ndertimi I rezervarit V=3000m<sup>3</sup> ne Baqevc

Punimet e izolimit te jashtem kan perfundue ne tersi , eshte duke vazhduar mbushja e rezervareve per rreth me material mbushes .

Takimet :

\*Me perfaqsesit e CDI dhe udheheqesit e njesive operative SU,MA,DR,PZ me 14/05/2014

Tema ; Investimet ne zonat rurale , pergaditja e project perpozimeve

\*Dita boterore e Metrologjise ne Republikën e Kosoves.

Dhurimi i paisjes ne shfrytezim per kalibrimin e ujematesave nga Ministria e Tregtis dhe Industrise

\*Fillimi I punimeve ne Drenas Kuvendi Komunal Malishevë -Rrjeti i ujesjellesit, Investim; Usaidi, K .Komunal Malisheve ,

\*Fillimi I punimeve ne Baqevc Faza e dyte - Hulmtimi i burimeve te reja "Krismat e Salih Shabanit" ne Mushtisht dhe ndertimi i rezervarit v=1000m<sup>3</sup>, mjetet e zotuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Financës me shumen 298,000.00 euro.

### III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË

#### 3.1 Aktivitetet

- Në fund të TM2 në njësinë e Prizrenit janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 40,091 fatura, prej tyre: 34.708 amvisëri , 4.767 biznese dhe 616 institucione. Në TM2 në krahasim me TM1 kemi 467 fatura të lëshuara me tepër. Një numër i këtyre konsumatorëve është si rezultat i pëlqimeve për kyçje (94 konsumatorë) ndërsa pjesa tjetër është rezultat i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës (373 konsumatorë).
- Gjatë muajit TM2 janë faturuar 1,738,987 m<sup>3</sup> ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1,438,987m<sup>3</sup>, biznese: 122,381 m<sup>3</sup> dhe institucione 175,915 m<sup>3</sup> ujë. Nëse e krahasojmë me TM1 kemi një faturim më të madh prej 83,477 m<sup>3</sup>. Rritje të sasisë së faturimit në krahasim me TM1 ka ndodh te të tri kategoritë e konsumatorëve: (te amvisëria +71,104 m<sup>3</sup>, te bizneset +15,784 m<sup>3</sup> dhe institucionet – 3,939 m<sup>3</sup>).

Sipas njësive kemi këtë gjendje (Prizreni + 95,658 m<sup>3</sup>, Malisheva - 27,744 m<sup>3</sup>, Suhareka + 10,017 m<sup>3</sup>, Dragashi + 5,546 m<sup>3</sup>.)

TM2 (prill,maj, qershor)

1	Uji i Faturuar	Njesia	1,738,033
2	Konsumatorët Shtëpiak	m <sup>3</sup>	1,438,987
3	Konsumatorët Komercial-Industrial	m <sup>3</sup>	122,381
4	Konsumatorët Institucional	m <sup>3</sup>	175,915

- Edhe pse inkasimi në kategorinë e bizneseve dhe amvisërive në TM2 ka qenë përafërsisht i njëjtë në krahasim me TM1. Në TM2 kemi të inkasuar më pak 66,719.37 euro. Ky ndryshim në inkasim është rezultat kryesisht të Spitali Rajonal” Daut Mustafa” , zyrtarët e spitalit në TM1 kanë paguar 65.909,45 euro (58,310.87 euro ne janar dhe 7,598.58 në muajin shkurt), ndërsa në TM2 kanë paguar vetëm 9,476.47 euro që dmth në TM2 vetëm të ky konsumator kemi 56,432.98 euro më pak të inkasuara.
- Sipas njësive kemi këtë gjendje (Prizreni - 63,813.96 €, Malisheva - 7,609.23 €, Suhareka + 773.21 € , Dragashi + 4,351.51 €)
- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe ç’kryje në Njësinë Operative në Gjatë këtij muaji në njësinë e Prizrenit nga ekipet e kontrollës janë vizituar 4,181 konsumatorë, janë regjistruar 404 konsumatorë ilegal të cilët bazuar në procedurat e brendshme janë legalizuar ndërsa janë shkyç 30 konsumatorë për lidhje ilegale dhe mospagesë .Konsumatorët të cilët janë hasur me lidhje ilegale janë shkyç menjëherë.

#### **Raport I ekipes së Kontrollës dhe shkyçjes**

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Shkyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi nga Kontro.
1	Prizren	228	9	5	1,896	26,586.70 €
2	Suharekë	163	4	11	1,258	8,354.00 €
3	Malishevë	12	17	14	1,027	3,495.68 €
4	Dragash	1	0	0	0	0.00 €
<b>5</b>	<b>KRU "Hidroregjioni Jugor"</b>	<b>404</b>	<b>30</b>	<b>30</b>	<b>4181</b>	<b>38,436.38 €</b>



## 3.2 RAPORT I MEDIAVE

## PRILL 2014

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	01.04.2014	TV- BESA	PRONONCIM: SHPIMI I BURIMEVE TË REJA TE MULLIRI
2	01.04.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË,PËR SHKAK TË DEFEKTIT NË Rr. BINGENI
3	01.04.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT NË REHABILITIMIN E RRJETIT NË Rr. FETAH GEGA DHE KADRI NESHO
4	03.04.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: REDUKTIME TË FURNIZIMIT ME UJË PËR SHKAK TË PROBLEMEVE ME RRYMË ELEKTRIKE (NJËSIA SUHAREKË)
5	04.04.2014	KOHA DITORE	ARTIKULLI: USAID-I E ZYRA ZVICERANE INVESTOJNË NË UJËSJELLËSN E DRENOCIT
6	09.04.2014	TV-BESA	PRONONCIM RRETH AKTIVITETEVE TË KOMPANISË
7	16.04.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM:MUNGESË E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA ZONA TË QYTETIT, SI PASOJË E PROBLEMEVE ME ENERGJI ELEKTRIKE
8	17.04.2014	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: PROBLEMET ME RRYMË, E LËNË PA UJË PRIZRENIN
9	23.04.2014	YEKHIPE RTK	PRONONCIM RRETH PUNIMEVE NË Rr. FETAH GEGA DHE KADRI NESHO

## MAJ 2014

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	10.05.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË, PËR SHKAK TË DEFEKTIT
2	20.05.2014	<a href="http://www.gazetaeprizrenit.com">www.gazetaeprizrenit.com</a>	ARTIKULLI: SOT INAUGUROHET LABORATORI PËR PËRGATITJEN E UJËMATËSVE PËR VERIFIKIM
3	20.05.2014	TV-OPINION	PËRURIMI I LABORATORIT PËR PËRGATITJEN E UJËMATËSVE PËR VERIFIKIM
4	20.05.2014	TV- BESA	PËRURIMI I LABORATORIT PËR PËRGATITJEN E UJËMATËSVE PËR VERIFIKIM
5	20.05.2014	TV-PRIZRENI	PËRURIMI I LABORATORIT PËR PËRGATITJEN E UJËMATËSVE PËR VERIFIKIM
6	20.05.2014	RTK	PËRURIMI I LABORATORIT PËR PËRGATITJEN E UJËMATËSVE PËR VERIFIKIM
7	21.05.2014	<a href="http://www.rtklive.com">www.rtklive.com</a>	ARTKULLI: PËRURUHET LABORATORI PËR PËRGATITJEN E UJËMATËSVE PËR VERIFIKIM
8	21.05.2014	<a href="http://www.tv-opinion.com">www.tv-opinion.com</a>	ARTIKULLI:NË PRIZREN SHËNOHET DITA BOTËRORE E METROLOGJISË
9	22.05.2014	LAJM	ARTIKULLI:NË PRIZREN U PËRURUA LABORATORI PËR PËRGATITJEN E UJËMATËSVE PËR VERIFIKIM
10	22.05.2014	<a href="http://www.prizrenpress.com">www.prizrenpress.com</a>	ARTIKULLI:FILLOI NDËRTIMI I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT NË DRENOC
11	23.05.2014	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: DRENOCI BËHET ME RRJET TË UJËSJELLËSIT
12	30.05.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM ME RASTIN E PËRURIMIT TË REZERVUARIT NË BAQEVIC- SUHAREKË
13	31.05.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË, PËR SHKAK TË PUNIMEVE TE SHESHI I LIDHJES SË PRIZRENIT

## QERSHOR 2014

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	01.06.2014	www.kosovapress.com	ARTIKULLI: NESËR PËRUROHET REZERVUARI I UJIT NË SUHAREKË
2	02.06.2014	TV- PRIZRENI	PËRURIMI I UJËSJELLËSIT NË BAQEVIC- SUHAREKË
3	02.06.2014	TV-OPINION	PËRURIMI I UJËSJELLËSIT NË BAQEVIC- SUHAREKË
4	02.06.2014	www.gazetaexpress.com	ARTIKULLI: SOT DO TË BËHET PËRURIMI I REZERVUARIT TË UJIT, TEK VENDI I QUAJTUR KRISMAT E SALI SHABANIT NË SUHAREKË
5	02.06.2014	www.koha.net	ARTIKULLI: UJI I PIJSHËM, PROBLEM I ZGJIDHUR PËR BANORËT E SUHAREKËS
6	02.06.2014	www.gazetaexpress.com	ARTIKULLI: UJI I PIJSHËM, PROBLEM I ZGJIDHUR PËR BANORËT E SUHAREKËS
7	02.06.2014	www.rtv21.tv	ARTIKULLI: UJI I PIJSHËM, PROBLEM I ZGJIDHUR PËR BANORËT E SUHAREKËS
8	02.06.2014	www.kosovapress.com	ARTIKULLI: SOT PËRUROHET REZERVUARI I UJIT NË SUHAREKË
9	02.06.2014	www.gazetaeprizrenit.com	ARTIKULLI: PËRUROHET UJËSJELLËSI I RI NË THERANDË
10	02.06.2014	<a href="http://www.gazetajetanekosove.com">www.gazetajetanekosove.com</a>	ARTIKULLI: PËRURIMI I UJËSJELLËSIT NË SUHAREKË
11	02.06.2014	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: PËRURIMI I UJËSJELLËSIT NË SUHAREKË
12	18.06.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM- DËGJIM PUBLIK ME QYTETARËT DHE PALËT E INTERESUARA
13	18.06.2014	GAZETA LAJM	NJOFTIM: DËGJIM PUBLIK
14	24.06.2014	TV - BESA	PRONONCIM LIDHUR ME DEBATIN PUBLIK
15	24.06.2014	TV- OPINION	DEBAT PUBLIK ME QYTETARË
16	24.06.2014	TV- PRIZRENI	DEBAT PUBLIK ME QYTETARË
17	27.06.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË, PËR SHKAK TË PROBLEMEVE ME RRYMË ELEKTRIKE

### 3.3 Pengesat në realizimin e objektivave

- Mospagesat e rregullta e rregullta mujore nga konsumatorët e madhej (institucionet)
- Pamundësitë teknike në realizimin e shkyçjeve te konsumatorët që jetojnë në ndërtesa kolektive(banesa)
- Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellësit :
  1. Te konsumatorët e amvisërisë- gjendja e rënde ekonomike
  2. Te bizneset – pamundësia e pagesave rrjedhëse e cila vjen nga rënia e punës në biznese.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për ti paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mos furnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktime) po ndikojnë në inkasim të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit

### 3.4 Planet për të ardhmen:

- Stimulimi i inkasantëve në nënshkrimin e kontratave me konsumatorë në teren për ri programimin e borxheve mbi 200 euro.
- Ndryshimi i faturës mujore për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, ku nga muaji korrik e tutje konsumatorët mund të paguajnë me KOS-GIRO te secila bankë komerciale.
- Vazhdimësia e punës së ekipeve të kontrollit për së bashku me operativen për shkyçjen e konsumatorëve borxhlinj të mëdhenj mbi =300,00 euro, të cilët nuk bëjnë pagesa dhe ri programim të borxhit..
- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shuma të larta të borxheve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për ri programimin e borxheve në mënyrë që këta konsumatorë të futen në sistem të pagesave të faturave
- Konsumatorët të cilët shkyçen nga rrjeti për mos pagës nuk do të ri kyçen pa i paguar së paku 30% të borxhit total .
- Marrja e masave ligjore sipas Zyrës Rregullative për shkyçjen e konsumatorëve për mos pagesë.
- Rritja e efikasitet të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyçjes.
- Pardia e konsumatorëve në gjykatë për mos pagesë.
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borxheve aty ku kanë vështirësi inkasantët.

#### IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

##### 4.1.1 Aktivitetet Prill-Qershor 2014

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marrë me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e marra nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji, komiteti për staf dhe shpërblime dhe Kryeshafi Ekzekutiv.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lëmia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njësive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- **Janë përtërirë Marrëveshjet e Shërbimit për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza me Komunën e Prizrenit, Suharekës dhe Dragashit. Pas skadimit të afatit fillestar janë vazhduar edhe për katër(4) vjet të tjera.**
- Në Departament të Administratës kemi pas auditim nga Auditori i Jashtëm “Kanuni i Auditorit” për vitin 2013.
- **Janë përgatitur dhe shpallur në shtypin ditorë 8 (tetë) konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë.**
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendeve të punës me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- I është ndërprerë kontrata e punës një punëtori në njësinë e Prizrenit (B.Sh) ngase nuk është lajmëruar disa ditë në vendin e tij të punës dhe nuk ka bërë asnjë njoftim për mosardhjen e tij në punë. Në njësinë e Malishevës për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës punëtorit F.K I është ndërprerë kontrata e punës me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës .
- Një punëtor I njësisë së Suharekës është lënduar në vendin e tij të punës dhe në përputhje të nenit 5. paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë punonjësit I është bërë pagesa e shpenzimeve të mjekimit nga lëndimi në punë.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Universitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit, Menaxhimit të burimeve njerëzore, Menaxhimit të Projekteve, në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikëqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
- **Në përputhje me nenin 95 të Ligjit e Punës në Kosovë Nr. 03/L-212, dhe nenit 7, alineja 2 e Statutit të Kompanisë, Bordi i drejtorëve ka Aprovuar njëzëri “Rregulloren mbi Përgjegjësin Disiplinore dhe Materiale të Punëtorëve të K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. – Prizren.**
- Janë përpiluar dispozita të përgjithshme lidhur me detyrat dhe obligimet e rojtarëve nëpër objektet e KRU “Hidroregjioni Jugor” sh.a, nder të tjera përfshihen edhe formulari i procesverbalit gjatë pranim-dorëzimit të ndërrimit dhe formulari I procesverbalit nëse ka ndodhur ndonjë defekt në objekt.
- Përgjigje NJPMNP që nuk kemi pasur kërkesë për qasje në dokumentet publike për periudhën janar-mars 2014 nga asnjë profil i aplikuesve dhe se në të ardhmen nëse paraqiten kërkesa të tilla do të trajtohen në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.

- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar ne Njësi lista e udhëtimeve zyrtare të punonjësve te KRU"Hidroregjioni Jugor" gjatë vitit 2013 si dhe lista me sqarimin e dhënë nga shërbimi financiar lidhur me sponsorimet dhe donacionet nga KRU"Hidroregjioni Jugor"sh.a Prizren.
- Pjesëmarrja në grupin punuese në SHUKOS për rishikimin dhe ndryshimin e Statutit të SHUKOS-it.

**PERSONELI – PRILL– QERSHOR 2014**

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Vërejtje
Prill	303	2	1	0	2 punt.push.pa pages
Maj	302	0	1	0	
Qershor	304	2	0	1	1 punëtor i pensionuar

**NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: QERSHOR 2014**

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	251	36	6	11	304
Numri i Punëtorëve në %	82.6	11.8	2.0	3.6	<b>100</b>

**NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË**

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	33	10.86	
MESHKUJ:	271	89.14	
TOTAL	304		

**KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: QERSHOR 2014**

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	<b>29</b>	<b>19</b>	<b>0</b>	<b>195</b>	<b>0</b>	<b>56</b>	<b>5</b>	<b>304</b>
Kualifikimi në %	<b>9.54</b>	<b>6.25</b>	<b>0.00</b>	<b>64.14</b>	<b>0.00</b>	<b>18.42</b>	<b>1.64</b>	

**RAPORTI I TREMUJORIT TË DYTË  
LIDHUR ME PUNËT E KRYERA ME GJYQËSORIN  
PRILL – QERSHOR 2014**

Periudha raportuese	Padi	Përgjigje në padi	Propozim për Ekzekutim	Kallëzime Penale	Seancat përgatitore	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	Deklarata në Prokurori	Parashtresa në Gjykata	Parashtresa në Prokurori	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruar nga Kompania	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruar nga	Përgjigje në Ankesat e Parashtruar në Gjykatën e Apelit nga	Kundërshtimet nga Debitorët	REVIZION	Përgjigje në Revizion	Vendimet e Revizionit	TOTALI	Totali i lëndëve të ardhura nga Gjykatat
PRILL	1	1	/	/	/	2	5	/	3	/	/	/	/	/	/	/	/	12	15
MAJ	/	/	/	/	/	1	2	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	3	10
QER.	/	/	/	/	/	2	3	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	5	8
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>5</b>	<b>10</b>	<b>/</b>	<b>3</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>20</b>	<b>33</b>

#### PARASHTRESA

Me datë **09.04.2014**, janë bërë 2 (dy) parashtresa për Gjykatën Themelore në Prizren lidhur me shtyrjen e dy Seancave të parapara për me 11.04.2014.

Me datë 10.04.2014, janë shkruar 2 (dy) Parashtresa për Gjykatën Themelore me kërkesë për shtyrje të seancave Gjyqësore.

Me datë 18.04.2014, është shkruar një parashtresë për Gjykatën Themelore në Prizren me Kërkesën për dërgimin edhe të provave nga lënda Padi me Padi tësin Enver Vila.

Me datë 18.04.2014 është shkruar një Parashtresë për Gjykatën Themelore në Prizren me kërkesën që të na jepet materiali i plotë lidhur me Padinë e parashtruar nga z. Enver Vila pasi që në shkresat e lëndës nuk ishin Provat e parashtruar nga Padi tësi.

Me datë 02.05.2014, është bërë Kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit në Prizren lidhur me Padinë e ushtruar nga z.Enver Vila.

Me datë 02.05.2014, është bërë një Kërkesë në Drejtorinë e për Çështje Pronoro-Juridike në Prizren lidhur me Padinë e ushtruar nga z.Enver Vila.

Me datë 27.06.2014 është bërë **Kërkesë – NJOFTIM** - për PROKURORINË PUBLIKE në Prizren – **SHËRBIMIT SPROVUES – NJËSIA REGJIONALE NË PRIZREN**, ku nga ky shërbim kemi bërë Kërkesë që të na njoftoj se a ka vepruar sipas Aktvendimit Pm.nr. 73/2009 të datës 24.05.2012, lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj Kompanis sonë.

#### PADI TË USHTRUARA KUNDËR KOMPANISË

Me datë **18.04.2014**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren PADI, C.nr. 1078/13, datë **17.04.2014**, me të cilën paditësi **ENVER VILA, Rr. Suzi Qelebi, nr. 72 në Prizren** kërkon **DËMSHPËRBLIM në vlerë prej 24.000,00 €** me kamatë nga data e ngritjes së kësaj Padië në Gjykatë nën pretekstin se Kompania jonë ia ka dëmtuar një sipërfaqe toke prej 0.3 Ari.

Me datë 23.06.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **PADI & (THIRRJE PËR SHQYRTIM KRYESORË me datë 14.07.2014. në ora 10.30, Zyra nr. 208, ku ne jemi TË PADITUR)**, LËNDA C.nr. 391/12, datë 20.06.2014, me të cilën paditësi **DURAK JASHARAJ, Rr. Nuhi Elezi, nr. 90 në Prizren** kërkon **DËMSPËRBLIM në vlerë prej 15.000 €** për shkak të dëmeve të shkaktuara në shtëpinë e tij nga plasja e gypit të ujit të pijshëm.

#### **PËRGJIGJE NË PADI**

Me date **29.04.2014**, është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren **PËRGJIGJE NË PADI-në C.nr. 1078/14, datë 17.04.2014 ndaj Paditësit ENVER VILA.**

#### **KËRKESË PËR PRECIZIM TË PROPOZIMIT PËR EKZEKUTIM**

Me datë 23.06.2014, është sjellë nga Gjykata e Themelore në Prizren **AKTVENDIM, Cp.nr. 1494/13, datë 02.09.2013**, sipas të cilit kërkohet nga Kompania jonë që në këtë Gjykatë të dërgohet **PRECIZIM I PROPOZIMIT PËR EKZEKUTIM**, nën kërcënimin se mospërmbushja e kërkesës sipas këtij Aktvendimi kjo Gjykatë do të merr vendim me të cilin do ta HEDH poshtë si jo të plotë Propozimin për ekzekutim.

#### **PRECIZIM I PROPOZIMIT PËR EKZEKUTIM**

Me datë **25.06.2014**, është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren Parashtresë me të cilën bëhet Precizimi i propozimit për ekzekutim të Aktvendimit Cp.nr. 1494/13, date 19.06.2014 ndaj Debitorit **OSMAN HOXHA, Rr. Ortakoll, Hyrja 7/4, në Prizren.**

#### **ANKESA NË GJYKATËN E APELIT KUNDËR KRU-së**

Me datë 07.04.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **ANKESË** në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nga **SADYDIN KAZAZI** nga Prizreni, Rr. Carraleva, nr. 115, për lëndën **C. nr. 793/06, datë 25.03.2014, me të cilën ankohet ndaj këtij Aktgjykimi.**

#### **PËRGJIGJE NË ANKESA**

Për këtë tremujor nuk ka pasur Ankesa të çfarëdo lloji kundër Kompanisë .

#### **VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE NË FAVOR TË KOMPANISË**

1. Me date 02.04.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTGJYKIM për lëndën C. nr. 793/06, datë 25.03.2014**, me të cilin OBLIGOHET I PADITURI **SADYDIN KAZAZI** nga Prizreni, Rr. Carraleva, nr. 115, që Kompanisë sonë t'ia paguaj shumën e të hollave në vlerë prej **376.02 €**, si dhe **25 €** në emër të shpenzimeve procedurale në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.
2. Me datë 17.04.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM** me të cilin **PËRFUNDON** procedura përmbimore e caktuar me Aktvendimin për përmbarim të kësaj Gjykate E.nr. 874/07, të dates 21.02.2007, kundër **DEBITORIT YMER KRYEZIU** nga Prizreni, Rr. "Haxhi Zeka", nr. 30, **DEBITORI KA PËRMBUSHUR DETYRIMIN** (Debitori e ka përmbushur në tërësi detyrimin)



3. Me datë 18.04.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM** me të cilin **APROVOHET** si propozim për kthim në gjendjen e mëparshme të kreditorit të përmbarimit në lëndën përmbarimore E.nr. 684/2007 të datës 12.03.2014, DHE LEHET jashtë fuqie ky **AKTVENDIM** ndaj **DEBITORIT ADIL QABRATI** nga Prizreni.

4. Me datë 28.04.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM** me të cilin **KONSTATOHET se Revizioni i Paditësit AHMET RAMA lidhur me kthimin e tij në vendin e tij të punës ËSHTË TËRHEQUR.**

5. Me datë 16.05.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTGJYKIM për lëndën C. nr. 710/05, datë 25.04.2014**, me të cilin **OBLIGOHET I PADITURI SHABAN HOXHA** nga Prizreni, Rr. Eesley Clark, pn, që Kompanisë sonë t'ia paguaj shumën e të hollave **PËR BORXH** në vlerë prej **239.29 €**, si dhe **30 €** në emër të shpenzimeve procedurale në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

6. Me datë 22.05.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM për lëndën CP. nr. 1498/2013, datë 16.05.2014**, me të cilin njoftohemi se **PËRFUNDON** Procedura e Përmbarimit sipas këtij Aktvendimi ngase **DEBITORI DASHNOR GËRMIZAJ**, Rr. Sylejman Vokshi, nr. 2 nga Prizreni **E KA PËRMBUSHUR DETYRIMIN.**

7. Me datë 29.05.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM për lëndën E. nr. 1500/13, datë 28.05.2014**, me të cilin njoftohemi se **PËRFUNDON** Procedura e Përmbarimit sipas këtij Aktvendimi ngase **DEBITORI IRFAN BOJAXHIU** nga Prizreni **E KA PËRMBUSHUR DETYRIMIN.**

8. Me datë 23.06.2014 është sjellë nga Gjykata e Apelit të Prishtinës **AKTGJYKIM PËR SHKAK TË MOSBINDJES për lëndën III. C.nr. 463/13 datë 05.06.2014**, me të cilin njoftohemi se **APROVOHET NË TËRËSI KËRKESËPADIA E KOMPANISË SONË**, dhe se **DETYROHET** e paditura **N.N.T. "Çlirimi"**, me seli në F. Korishë, Prizren që në emër të borxhit ti paguaj Kompanisë sonë shumën e përgjithëshme prej 401,59 Euro me kamat ligjore 3.5% nga data e parashtrimit të Padisë me datë 02.04.2010, deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh.

#### **VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE KUNDËR KOMPANISË**

1. Me datë 07.05.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM lidhur me lëndën C.nr. 3691/13**, me të cilin **PRANOHET** Ankesa e Kreditorit **NJAZI ADEMAJ** nga F.Zhur, KK Prizren dhe **PRISHET AKTVENDIMI** i Gjykatës Themelore në Prizren E.nr.1515/13, të datës 02.10.2013, dhe lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë **NË RIVENDOSJE.**

2. Me datë 13.06.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM** për lëndën **C. nr. 399/06**, sipas të cilit Padia e Kompanisë ndaj Konsumatorit **IDAJET BERISHA**, Rr. Salajdin Braha, pn. në Preizren, **HUDHET POSHTË SI E PA LEJUAR.**

3. Me datë 23.06.2014, është sjellë nga Gjykata e Themelore në Prizren **AKTVENDIM**, Cp.nr. 1494/13, datë 02.09.2013, sipas të cilit kërkohet nga Kompania jonë që në këtë Gjykatë të dërgohet **PRECIZIM I PROPOZIMIT PËR EKZEKUTIM**, nën kërcënimin se mospërmbushja e kërkesës sipas këtij Aktvendimi kjo Gjykatë do të merr vendim me të cilin do ta HEDH poshtë si jo të plotë Propozimin për ekzekutim.

#### **LËNDË TË ARDHURA NGA PROKURORIA**

1. Me datë 14.04.2014, është sjellë nga **Prokuroria** Themelore në Prizren Lënda HP.nr. 300/2013, datë 11.04.2014 **NJOFTIM** me të cilin njoftohemi se është HEDHUR POSHTË KALLËZIMI PENAL ndaj **Hashim Kryeziu dhe Kahriman Kahrmani**, i pari sipas PARASHKRI-MIT, ndërsa i dyti se nuk është vërtetuar se ekziston dyshim i arsyeshëm se e ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtarë për çka që të dy kanë qenë të dyshuar.

#### **KUNDËRSHTIME NGA KONSUMATORËT DEBITORË**

1. Me datë 07.04.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM për lëndën C. nr. 642/2005, datë 05.09.2005**, me të cilin REFUZHET KUNDËRSHTIMI I DEBITORIT **ENVER XHELADINI** nga Prizreni, Rr. "Haxhi Zeka", nr. 30, kundër Aktvendimit mbi lejimin e ekzekutimit të kësaj Gjykate.

2. Me datë **23.06.2014**, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **KUNDËRSHTIM** për lëndën **E. nr. 682/07**, sipas të cilit z. **MEHMET SHISHKO**, Rr. Halil Berisha nr. 26 në Prizren e kundërshton **AKTVENDIMIN** e Gjykatës Themelore në Prizren **E. Nr. 682/07**, sipas të cilit **APROVOHET Propozimi për ekzekutim të borxhit në shumën prej 545.17 Euro i Kompanisë**, ku paraqitësi i kundërshtimit thirret në Kontratën mbi shfrytëzimin e lokalit me qera.

3. Me date 27.05.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **KUNDËRSHTIM** për lëndën **Ekz. nr. 1494/13**, me të cilin njoftohemi se DEBITORI **ASMAN HOXHA**, ka parashtruar këtë kundërshtim ndaj kërkesës së Kompanisë.

### PËRGJIGJE NË KUNDËRSHTIME

1.Me datë **27.06.2014**, është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren **PËRGJIGJE NË KUNDËRSHTIM** lidhur me lëndën E.nr. 682/07, të parashtruar nga z. **MEHMET SHISHKO**.

### NDËRPRERËJET E PROCEDURAVE SI PASOJË E VDEKJES SË DEBITORËVE

Me datë 05.05.2014, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren **AKTVENDIM** lidhur me lëndën **C.nr. 319/06**, me të cilin NDËRPRITET çështja juridike kontestimore **për shkak të vdekjes së të Paditurit për borxh, MUZAFER PAÇARIZI**, Rr. Sahat Kulla, nr.86, Prizren.

### Masat e ndërmarra nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me Paditë e bëra nga KRU për kyqjen ilegale të konsumatorëve për periudhën kohore Prill - Qershor 2014

Për këtë Tremujorë nuk kemi informata nga KK Prizren lidhur me masat eventuale të ndërmarra nga Gjykata për kyqje dhe rikyqje ilegale të konsumatorëve edhe përkundër kërkesës sime të vazhdueshme.

### Paraqitja tabelare e Vendimeve të lëshuara nga Ankesat e konsumatorëve

Gjatë këtij tremujori janë shqyrtuar edhe Ankesat e konsumatorëve të cilat janë shqyrtuar në aftin optimal nga Komisioni për shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve ku janë nxjerrë Vendime dhe të njëjtat u janë dërguar konsumatorëve.

Muaji	Sasia e Vendimeve të lëshuara	Vërejtje
<b>Prill</b>	<b>30</b>	
<b>Maj</b>	<b>37</b>	
<b>Qershor</b>	<b>31</b>	
<b>Totali</b>	<b>98</b>	

### ZYRA PËR MBROJTJE DHE SIGURI NË PUNË

Nga Zyra për mbrojtje dhe siguri në punë gjatë tremujorit të dytë 2014 janë kryer:

Është përfunduar puna rreth Rregullores për mbrojtjen nga zjarri, mirëpo pas përfundimit të punës para 3 javësh, nga Ministria e Mirëqenies në Punë e kemi marrë një Projekt-Rregullore të re për Mbrojtjen nga Zjarri në nivel të Kosovës, kështu që duhet të pritet finalizimi dhe aprovimi i Rregullores nga ana e Qeverisë së Kosovës ku më pastaj duhet edhe një herë të rishikohet Rregullorja e Kompanisë dhe të harmonizohet me Rregulloren e Ministrisë;

Është komunikuar me shkresa dhe kontakte fizike me institucione të ndryshme, me Njësinë e Zjarrfikësve, Kuvendin Komunal etj.

Kemi kryer vizita nëpër disa nga objektet të cilat janë me prioritet lidhur me punët që duhet kryer nëpër këto objekte;

Janë kryer edhe punë tjera nga fushë-veprimtaria e zyrës për siguri në punë;

Kemi bashkëpunuar ngushtë me Zyrën ligjore për të gjitha punët e lartcekura, ku bashkëpunimi ka qenë i ndërsjellë dhe me interes për Kompaninë.

## **Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për prill - qershor 2014**

### **Përshkrimi hyrës;**

Aktivitetet e punës së përditshme detalisht janë pasqyruar në raportet ditore të cilat plotësohen në fund të orarit të punës. Këto raporte janë të gatshme në çdo kohë të prezentohen para autoriteteve dhe udhëheqësve të Kompanisë.

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionimit optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka patur peshe dhe ndikim të veçantë.

Në konsultë me Menaxherin, kam përpiluar një pasqyrë ditore raportuese për evidentim të aktiviteteve të përditshme e cila e njëjta do të shërben për përpilimin e raporteve periodike dhe vjetore..

### **Raporti**

- Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.
- Nderhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 13 herë.
- Nderhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 19 herë.
- Nderhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 13 herë.
- Nderhyrje në njesitë Shatërvan: 12 herë.
- Nderhyrje në njesitë Depo: 8 herë.
- Nderhyrje në njesinë Filtrat: 22 herë.
- Nderhyrje në Ueb Faqe 6 herë.
- Nderhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 260 herë.
- Përkujdesje për qasjen e kompanisë në rrjetin e internetit.
- Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njërive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.
- Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.
- Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të kompanisë
- Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.
- Mbikqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe serviseve të paisjeve kompjuterike e paisjeve të ngjajshme teknike.
- Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.
- Përditësim i ueb faqes së Kompanisë.
- Është furnizuar Serveri i ri i dedikuar për Databazë.
- Krijimi i arkave dhe perdoruesve të rinje, në përputhje me kërkesat e Kompanisë.
- Zhvillim i trajnimeve me studentë Universiteti.
- Konfigurim i virtual servereve në përputhje me kërkesat e Kompanisë.
- Përkujdesje ditore në ruajtjen e shënimeve të serverëve.

### Propozimet – kërkesat

- Kompletimi dhe sjellja e rregullt e shenimeve per ueb faqe. Meqenese ueb faqja eshte ndertuar ne ate menyre qe aktualitetet, oraret e reduktimeve të ujit të pijes, aktivitetet e prokurimit, dokumentet duhen perditesuar, atehere do te ishte mire qe te sillen nga sherbimet perkatese. Për 3 muaj sa është publikuar ueb faqja, kemi pasur mbi 3000 klikime, ndërsa përditësimet janë bërë vetëm 6 herë në 3 muaj.
- Pasi furnizimi i disa zyreve me paisje kompjuterike po ndodh pa njoftimin apo sugjerimin tonë si shërbim i IT, propozojmë që në vijim porositja apo furnizimi i paisjeve kompjuterike te behet permes miratimit apo pelqimit paraprak te zyles së IT me qëllim të evitimit të grumbullimeve të panevojshme apo stërngarkimit, ç'rregullimit të mbarëvajtjes së procesit punues por dhe kursimit të Kompanisë.
- Meqenëse Depoja dhe portoarka në njësinë e Malishevës nuk janë ende të kyqura në rrjetin e aplikacionit NAVISION kërkoj blerjen e një VPN Routerëve për instalim në Depo.
- Instalimi i mëparshëm i rrjetit kompjuterik i hasur në objekt ka vendosur kabinetet kompjuterike (RACK) në koridor i cili për shkaqe sigurie dhe të tjera nuk preferohet prandaj propozoj dhe kërkoj që të sigurohet një kthinë e veçantë brenda objektit me kushte të parapara ventilimi e sigurie që kabineti i tillë të vendoset në te. Me këtë aksion do të mënjanohej edhe vërejtja rreth gjendjes dhe sistemimit të kabineteve kompjuterike. Duhet gjetur hapësire (dhome) e posaqme per vendosjen e te gjithë servereve ne te.
- Blerja e dy VPN Routerëve për Depo, Malisheve. Keto paisje ende nuk jane sjelle nga kontraktori, ndersa porosia eshte bere para 10 muajve, ndërsa rikërkesa para 3 muajve.
- Është licensu programin Èatercad v8i, program ky i licensuar per një vit nga Bentley. Licensa kushtonte 6666 Euro per nje vit.
- Janë duke u avancu ne mirmbajtjen e serverit NAVISION. Tashme nuk eshte e nevojshme mirmbajtja e printereve te faturave, hapja e ciklit mujor te faturave, postimit te faturave, printimit te faturave, kalkulimit te faturave, backupit ditor, mirmbajtja hardverike dhe softverike te serverit te databazes, rikthimit te shenimeve, krijimit te perdoruesve te rinje, kyçjës në Billing, krijimit të arkave të reja, mirmbajtës së arkave. Mirembajtje kjo e bere nga Asseco deri tani me çmim te larte.

#### Synimet për 3-mujorin e ardhshëm

##### **Këto janë disa nga synimet që do i realizoj në tre mujorin e ardhshëm.**

- Krijim i backup servereve ne njesi. Serveret kryesore do replikohen ne serveret e njesive ne menyre qe te krijohet redundance.
- Krijim i backup serverit kryesor. Nese serveri kryesor deshton, atehere per 10 minuta do e aktivizoj serverin tjeter.
- Krijim i antivirus serverit. Shume kompjutere nuk kane antivirusë. Do e krijoj nje server me antivirus ne qendër dhe t'ju shperndahet klientëve.
- Krijimi i ÈSUS Serverit (Ëindoës Server Update Services). Shume kliente ne fund te orarit mbash fikjes se kompjuterit fillojn instalimin e perditesimeve (update). Do provoj të krijoj nje server lokal qe i shkarkon updatat dhe i shperndan tek klientet.
- Krijim i TMG Serverit. Server i avancuar fireëall.

## V. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR

### 5.1 Aktivitetet Prill-Qershor 2014

Kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme dhe të arkëtueshme;  
 Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;  
 Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, me apo pa kontratë  
 Kontrollimi dhe nënshkrimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;  
 Rifreskimi i shënimeve; të pagueshmet dhe të arkëtueshmet  
 Kontrollimi i borxheve të konsumatoreve dhe borxhet ndaj furnitorëve, barazimi i furnitorëve si dhe pagesa ndaj tyre.  
 Përgatitja e raporteve mujore; faturimi, inkasimi dhe shpenzimet; ZRRUK, etj  
 Takime me kryeshefin lidhur me performancën e majit të kaluar të kompanisë si dhe takime me menaxherët e njësive.  
 Raportet ditore me shërbimet brenda departamentit të financave si dhe brenda ndërmarrjes;  
 Takim me menaxhmentin e kompanisë, me shërbimet përkatëse, etj;  
 Angazhim i departamentit të financave është në vazhdimësi në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të saj, në ofrimin e shërbimeve për sektorët tjerë të kompanisë në mënyrë që të përmirësohet dhe performanca e kompanisë.

### 5.2 Shpenzimet Prill-Qershor 2014

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e II-të të 2014, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të parë të vitit, kanë qenë më të ulëta, kjo ka ndikuar që edhe mbulueshmëria të jetë më e lartë. Më poshtë do t'i cekim disa nga arsyet dhe ndryshimet në disa nga pozicionet kryesore të shpenzimeve.  
 Nëse shikojmë shpenzimet në pozicionin e pagave, ato janë rritur në një përqindje të vogël të tyre, duke ditur se zona operuese po rritet dhe shërbimet ndaj konsumatorëve po bëhen më të mira, gjithashtu edhe numri i punëtorëve për këtë tre mujor është shtuar.  
 Te shpenzimet e energjisë elektrike kemi rënie të tyre, edhe pse kemi shtim të pompave të në burimet e reja që kompania ka hapur, shpenzimet e energjisë elektrike janë më të ulta sepse në tremujorin e dytë të vitit faturohemi me tarifën verore.  
 Te pozicioni i derivateve nuk kemi ndonjë ndryshim që do të ndikonte në shpenzimet totale, pra në këtë tremujor kemi një rënie të vogël të shpenzimeve për derivate.  
 Ndërsa te mirëmbajtja, kemi një rritje të shpenzimeve, pra nevoja për intervenime në rrjet dhe mirëmbajtje të pompave ka qenë më e lartë në këtë tre mujor në krahasim me tremujorin e fundit.  
 Investimet tona janë duke vazhduar në gjetjen e burimeve të ujit, lëshimin e rezervuarve të rinj të ujit, shtrirjen e rrjetit të ri të gypave të ujësjellësit, intervenimeve në rrjetin ekzistues, me ndihmën e donacioneve nga qeveria dhe komunat, si dhe nga investimet tona vetanake, duke ditur misionin tonë, në ofrimin e shërbimeve të gjithë qytetarëve në zonën ku ne operojmë.  
 Edhe pse angazhimi jonë në inkasim vazhdon me një përkushtim të shtuar, në këtë tremujor, në krahasim me tremujorin e parë, kemi një rënie të inkasimit. Shkak për këtë është se, inkasimi tek kategoria e institucioneve ka rënë, për arsye të mos alokimit të buxhetit të tyre, gjë që kjo ka ndikuar direkt në rënie të inkasimit.

### 5.3 RAPORTI I PERFORMANCES – TM1 – TM2- 2014

#### • NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	TM1- 2014	TM2- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	3,245,450	3,301,510	56,060	1.73
<i>Faturimi m3</i>	1,260,063	1,355,721	95,658	7.59
<i>Faturimi nga uji €</i>	697,262.49 €	743,284.62 €	46,022.13 €	6.60
<i>Faturimi- te tjera €</i>	10,804.85 €	10,967.93 €	163.08 €	1.51
<i>Faturimi Total €</i>	708,067.34 €	754,252.55 €	46,185.21 €	6.52
<i>Inkasimi nga uji €</i>	586,382.76 €	522,568.80 €	- 63,813.96 €	-10.88
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	7,203.85 €	14,524.60 €	7,320.75 €	101.62
<i>Inkasimi Total €</i>	593,586.61 €	537,093.40 €	- 56,493.21 €	-9.52
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	29,732	29,996	264	0.89
<i>% e inkasimit</i>	84.10	70.31	-13.79	-16.40
<i>Shpenzimet</i>	599,214.87 €	541,757.93 €	- 57,456.94 €	-9.59
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	1,985,387	1,945,789	(39,598)	-1.99
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	61.17	58.94	-2.24	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.99	0.99	0.00	
	- 5,628.26 €	- 4,664.53 €		

#### AKTIVITETET KRYESORE – SHËRBIMI TEKNIK:

##### Aktivitetet mujor - Njësia Prizren – TM-2 / 2014

**Prill, 2014** \*Furnizimi me ujë ka qenë i rregulltë në përgjithësi, në disa raste kur ka pasë ndërhyrje në mirëmbajtje në rrjet të ujësjellsit dhe gjatë punimeve ka pasur ndërprerje të ujit në eliminimin e defekteve.

\*Operacionet e mirëmbajtjes së ujësjellsit dhe të kanalizimit janë: Intervenime në rrjetin e ujësjellsit 91 aktivitete, në rrjetin e kanalizimit pastrimin e pusetave 91 raste në total janë kontrolluar 196 pusetat, janë bërë kontrollime të kanalizimit me gjatësi 3110 metra dhe kanë intervenuar në pastrimin e kanalizimit 2110 metra, njëherit janë bërë edhe riparuar të rruges 46 metra katror.

\*Gjatë muajit Prill i kemi shërbyer qytetaret me ujë edhe me cisternë 16 m<sup>3</sup>, kemi realizuar edhe pastrime dhe fryrje me kompresor duke intervenuar në 6 raste.

\*Trajtimi dhe klorifikimi: Këto veprime bëhen për çdo ditë, në marrje e analizave të ujit nga kompanisë sonë, Instituti i Shëndetit Publik dhe mostrat e marrun janë: Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike.

\*Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit - Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në qytet dhe regjion.

\*Gjat muajit Prill furnizimi me ujë në njesin e Prizrenit ka qene i rregullt, duke iu falenderuar aktiviteve me rastin e shtimit të sasis së ujit nga puset e reja .

**Maj.2014** \*Furnizimi me ujë ka qenë i rregulltë në përgjithësi, në disa raste kur ka pasë ndërhyrje në mirëmbajtje në rrjet të ujësjellsit dhe gjatë punimeve ka pasur nderprerje te ujit ne eliminimin e defekteve.

\*Operacionët e mirëmbajtjes së ujësjellsit dhe të kanalizimit janë: Intervenime në rrjetin e ujësjellsit 88 aktivitete, në rrjetin e kanalizimit pastrimin e pusetave 49 raste ne total janë kontrolluar 98 puseta, janë bere kontrollime te kanalizimit me gjatesi 1971 metra dhe kan intervenuar ne pastrimin e kanalizimit 1034 metra si dhe duke berë ndrrim te gypave te kanalizimeve 3 metra, njeherit janë bërë edhe riparuar të rruges prej 68 metra katror.

\*Gjatë muajit Maj i kemi realizuar edhe pastrime dhe fryrje me kompresor duke intervenuar në 9 raste.

\*Trajtimi dhe klorifikimi: Këto veprime bëhen për çdo ditë, në marrje e analizave te ujit nga e kompanisë son, Instituti i Shendetit Publik dhe mostrat e marrun janë: Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike.

\*Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit - Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në qytet dhe regjion.

\*Gjat muajit Maj furnizimi me ujë në njesin e Prizrenit ka qene i rregullt, duke iu falenderuar të reshurave si dhe aktiviteve me rastin e shtimit të sasis së ujit nga puset e reja .

**Qershor, 2014** \*Furnizimi me ujë ka qenë i rregulltë në përgjithësi, në disa raste kur ka pasë ndërhyrje në mirëmbajtje në rrjet të ujësjellsit dhe gjatë punimeve ka pasur nderprerje te ujit ne eliminimin e defekteve.

\*Operacionët e mirëmbajtjes së ujësjellsit dhe të kanalizimit janë: Intervenime në rrjetin e ujësjellsit 88 aktivitete (78 raste nre rrjetin sekundar dhe 10 raste ne rrjetin primar).

\* Në rrjetin e kanalizimit pastrimin e pusetave 49 raste ne total janë kontrolluar 98 puseta, janë bere kontrollime te kanalizimit me gjatesi 1971 metra dhe kan intervenuar ne pastrimin e kanalizimit 1034 metra , njeherit janë bërë edhe riparuar të rruges prej 68 metra katror.

\*Gjatë muajit Qershor i kemi realizuar edhe pastrime dhe fryrje me kompresor duke intervenuar në 9 raste.

\*Trajtimi dhe klorifikimi: Këto veprime bëhen për çdo ditë, në marrje e analizave te ujit nga e kompanisë son, Instituti i Shendetit Publik dhe mostrat e marrun janë: Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike.

\*Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit - Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në qytet dhe regjion.

\*Gjat muajit Qershor furnizimi me ujë në njesin e Prizrenit ka qene i rregullt, duke bazuar në shtimin e sasis së ujit nga puset e reja .

#### **MASAT E PROPOZUARA:**

\*Puna sa më me përgjegjësi dhe korrektësi të plotë në teren e Inkasantëve dhe ekipit të Kontrollës, në leximin e rregulltë të ujëmatësve, shpërndarjen e rregulltë të faturave, hulumtimin dhe zbulimin e lidhjeve ilegale në rrjet, si dhe pasivizimin apo eliminimin nga lista e konsumatorëve të cilëve nuk iu ofrohen shërbimet tona, ose për shkaqe objektive, nuk i shfrytëzojnë këto shërbime.

\*Ngritja e vazhdueshme e nivelit të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë në punë e shërbimit operativ në teren, duke siguruar furnizim sa më të mirë me ujë të pijshëm dhe me parametra optimal higjiëno-sanitar, riparimin efektiv dhe në kohë reale të defekteve të ndryshme që mund të shfaqen në rrjetin e ujësjellsit dhe kanalizimit, ashtu që ndikon në rritjen e imazhit pozitiv të Kompanisë tek konsumatorët dhe qytetarët në përgjithësi.

\*Ngritja e vazhdueshme e nivelit të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë në punë e shërbimit për konsumatorë, duke siguruar trajtim sa më korrekt dhe profesional të të gjitha ankesave dhe kërkesave të

konsumatorëve, shqyrtimin e tyre dhe kthimin e përgjegjës në kohë reale, si dhe eliminimin e anomalive të ndryshme në listat e konsumatorëve, siç është faturimi i dyfishtë, mbingarkimi eventual në muaj të caktuar, faturimi paushall i konsumatorëve që nuk dihet se pse janë regjistruar, derisa për kohë të gjatë ose nuk kanë ujë, ose nuk e shfrytëzojnë ujin e rrjetit, ashtuqë po krijohen borxhe të këqija dhe asnjëherë nuk kemi një gjendje përafërsisht reale në këto lista.

\*Ngritja e një grupi Kontrolle në nivel regional, në përbërjen e të cilit do të hynin edhe pjestarë të policisë, inspektorateve komunale e ndoshta edhe gjyqtarë dhe të cilët do të kishin përkrahjen e plotë të institucioneve, në mënyrë që menjëherë dhe në vend ngjarje të shqiptonin gjoba dhe të bënin ekzekutimin e tyre, deri në një disiplinim të plotë të konsumatorëve keqpërdorues të ujit dhe të stabilizimit eventual të gjendjes në teren.

\*Rritja e presionit ndaj Institucioneve komunale dhe bizneseve të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj Kompanisë tonë.

\*Bashkëpunimi me mediat lokale në sensibilizimin konsumatorëve në veçanti dhe opinionit publik në përgjithësi, mbi domosdoshmërinë e shfrytëzimit sa më racional të ujit, si një artikull jetik për kualitetin e jetës së qytetarëve dhe ndërgjegjësimin të vazhdueshëm të tyre për obligimet që kanë ndaj Kompanisë në shfrytëzimin legal të ujit dhe pagesën e tij.

\*Bashkëpunimi me Organet udhëheqëse komunale dhe Inspektoratin në arritjen e këtyre objektivave të parashtruara në pikën 5. qoftë edhe duke e kushtëzuar pagesën e ujit me ndonjë shërbim komunal, derisa kjo të parashihet si zgjidhje e duhur dhe e nevojshme, për çka jemi në koordinim të plotë edhe me Kryetarin e Komunës, për të gjetur një zgjidhje të pranueshëm.

\*Përfundimi i ndërtimit të Kaptazhës së re të ujit të burimi në Studenqan, pas hulumtimit dhe sigurimit të një sasive dukshëm më të madhe të ujit të pijes, ashtu që do të stabilizohet furnizimi si dhe do të rritet inkasimi.

#### AKTIVITETET KRYESORE – SHMK-FINANCA:

- Në fund të TM2 në njësin e Prizrenit janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 29.996 fatura, prej tyre: 25.886 amvisëri , 3.731 biznese dhe 399 institucione.Në TM2 në krahasim me TM1 kemi 264 fatura të lëshuara me tepër.Një numër i këtyre konsumatorëve është si rezultat i pëlqimeve për kyqje (36 konsumatorë) ndërsa pjesa tjetër është rezultat i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës (228 konsumatorë).
- Gjatë muajit TM2 janë faturuar 1,355,721 m<sup>3</sup> ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1,131,354 m<sup>3</sup>, biznese: 99,076 m<sup>3</sup> dhe institucione 125,291 m<sup>3</sup> ujë. Nëse e krahasojm me TM1 kemi një faturim më të madh prej 95,658 m<sup>3</sup>. Rritje të sasisë së faturimit në krahasim me TM1 ka ndodh vetëm te të tri kategoritë e konsumatorëve: (te amvisëria +73,288 m<sup>3</sup>, te bizneset +15,749 m<sup>3</sup> dhe institucionet +6,621m<sup>3</sup> ).

1	Uji i Faturuar	Njesia	1,355,721
2	Konsumatorët Shtëpiak	m3	1,131,354
3	Konsumatorët Komerical-Industrial	m3	99,076
4	Konsumatorët Institucional	m3	125,291

- Edhe pse inkasimi në kategorin e bizneseve dhe amvisërive në TM2 ka qenë përfaërsisht i njejtë me TM1. Në TM2 kemi të inkasuar më pak 56,493.21 euro. Ky ndryshim në inkasim është rezultat kryesisht te Spitali Rajonal” Daut Mustafa” , zyrtarët e spitalit në TM1 kanë paguar 65.909,45 euro (58,310.87 euro ne janar dhe 7,598.58 në muajin shkurt), ndërsa në TM2 kanë paguar vetëm 9,476.47 euro që dmth në TM2 vetëm të ky konsumator kemi 56,432.98 euro më pak të inkasuara.



- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe ç'kyçjes në Njësin e Prizrenit. Gjatë këtij muaji në njësin e Prizrenit nga ekipet e kontrollës janë vizitu 1,896 konsumatorë, janë regjistru 228 konsumatorë ilegal të cilët bazuar në procedurat e mbrendshme janë legalizuar ndërsa janë shkyq 9 konsumatorë për lidhje ilegale dhe mospagesë .Konsumatorët të cilët janë hasur me lidhje ilegale janë shkyq menjëher.

RAPORT I EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES -Prill-Qershor 2014

Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
Prizren	228	9	5	1,896	26,586.70 €

- **PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË MOS ARRITJEN E OBJEKTIVAVE:**

- Mospagesat e rregullta e rregullta mujore nga konsumatorët e mëdhëj (institucionet)
- Pamundësit teknike në realizimin e shkyqjeve te konsumatorët që jetojn në ndërtesa kolektive(banesa)
- Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellsit :
  3. Te konsumatorët e amvisërisë- gjendja e rënde ekonomike
  4. Te bizneset – pamundësia e pagesave rrjedhese e cila vjen nga rënia e punës në biznese.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për ti paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mosfurnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktime) po ndikojn në inkasim të shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit.

- **MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS**

- Stimulimi i inkasantëve në nënshkrimin e kontratave me konsumatorë në teren për riprogramimin e borxheve mbi 200 euro
- Ndryshimi i faturës mujore për shërbimet e ujësjellsit dhe kanalizimit, ku nga muaji korrik e tutje konsumatorët mund të paguajn me KOS-GIRO te secila bankë komerciale.
- Vazhdimësia e punës së ekipeve të kontrollit për së bashku me operativen për shkyqjen e konsumatorve borgjlinj të mëdhej mbi =300,00 euro, të cilët nuk bëjn pagesa dhe riprogramim të borxhit..
- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kan shuma të larta të borgjëve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për riprogramimin e borgjëve në menyrë që këta konsumatorë të futen në sistem të pagesave të fakturave
- Konsumatorët të cilët shkyqen nga rrjeti për mos pages nuk do të rikyqen pa i paguar së paku 30% të borgjit total .
- Marrja e masave ligjore sipas Zyres Rregullative për shkqjen e konsumatorve për mos pages.
- Rritja e efikasitet të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyqjes.
- Padia e konsumatorve në gjykatë për mos pagesë.
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borgjeve aty ku kan vështirsi inkasantet.

• NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	TM1- 2014	TM2- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	516,305	544,612	28,307	5.48
<i>Faturimi m3</i>	184,881	194,898	10,017	5.42
<i>Faturimi nga uji €</i>	101,745.79 €	106,436.73 €	4,690.94 €	4.61
<i>Faturimi- te tjera €</i>	3,408.41 €	3,875.85 €	467.44 €	13.71
<i>Faturimi Total €</i>	105,154.20 €	110,312.58 €	5,158.38 €	4.91
<i>Inkasimi nga uji €</i>	61,828.63 €	62,135.46 €	306.83 €	0.50
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	3,409.49 €	3,875.87 €	466.38 €	13.68
<i>Inkasimi Total €</i>	65,238.12 €	66,011.33 €	773.21 €	1.19
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	4,902	5,056	154	3.14
<i>% e inkasimit</i>	60.77	58.38	-2.39	-3.93
<i>Shpenzimet</i>	97,073.48 €	81,991.66 €	- 15,081.82 €	-15.54
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	331,424	349,714	18,290	5.52
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	64.19	64.21	0.02	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.67	0.81	0.13	
	- 31,835.36 €	- 15,980.33 €	15,855.03 €	

**SHËRBIMI TEKNIK  
AKTIVITETET TRE MUJORE – NJËSIA NË SUHAREKË  
TM2 – 2014**

**Njesia Suharekë, TM-2 / 2014**

**Prill, 2014** \* Furnizimi me ujë gjatë muajit Prill/2014 për pjesësn më të madhe të zonës së shërbimit ka pasur problem me furnizim me ujë pasi që gjatë këtij muaji ka pasur ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike e sidomosë kjo mungesë më së shumti është vërejtur në dy rrugët “Gjavitt Syla 1” dhe “Gjavit Syla-2” në Suharekë

\*Analizat e ujit gjatë muajit Prill/2014 janë realizuar 10 mostra të analizave bakteriologjike dhe 10 mostra i’u kan përgjigjë standardeve sipas Institutit të Shëndetit Publik

\*Rregullimi i defekteve -Në muajin Prill/2014 është intervenuar në 53 defekte dhe atë 35 në rrjetin sekondar dhe në kyqjet individuale 9 debllokime të kanalizimeve dhe 9 defekete në stacione të pompimit.

\*Hapja e kanalit dhe vendosja e gypave për 2 puseta në lumë në SP-Baqec - Për dy puseta në lum janë vendosur pusetat e puseve dhe është hapur kanali ku janë vendosur gypat e ujit dhe kabllot e rrymës për të dy puset veq e veq deri në afërsi të rezervarit kryesorë.

Janë bërë lidhjet e gypave e të gjitha puseve në rezervarin kryesor gjithësej 8 puseve me gypa të veqant më diametra të ndryshëm mvarsishtë nga sasia e ujit në puse.

\*Pastrimi i objekteve:Rezervareve, stacionet e pompave dhe kaptazha- Gjatë mujit Prill/2014 janë pastruar dhe dezinfektuar rezervaret e ujit në Reshtan, Savrovë, kaptazha Sopi dhe Stacionet e pompave Reshtan, Savrovë.

**Maj, 2014** \*Furnizimi me ujë gjatë muajit Maj/2014 në ditët e fundit të muajit edhe pse është aktivizura edhe një pompë në SP-Pusi Atit nuk ka qenë e mundur që rrugët "Gjavitt Syla 1" dhe "Gjavitt Syla-2" në Suharekë të kenë furnizim të rregulltë në këtë pjesë ujë ka pasur 18-20 orë në ditë, ndërsa për shkak të punimeve në burimin në fshatin Studenqan ka pasur herë pasë here problem në furnizim e sidomos pjesa e fshatit që furnizohet me gravitet, ndërpreje të ujit ka pasur edhe në fshatin Savrovë për shkak të problemit me pompë, ndërsa fshati Sallagrazgdë derisa është lidhur me rezerverin kryesor në Baqec ka pasur problem pasi që vetëm një pompë nuk ka arritur të furnizojë komplet fshatin.

Analizat e ujit Maj-2014 - janë realizuar 15 mostra të analizave bakteriologjike dhe 15 mostra i'u kanë përgjigjë standardeve ndërsa 2 mostra nuk janë përgjigjur standardeve sipas ISHP. Rregullimi i defekteve Maj-2014 - është intervenuar në 52 defekte dhe atë 46 në rrjetin sekondar dhe në kyqjet individuale 1 në rrjetin kryesor 5 deblokime të kanalizimeve.

Punet përfundimtare për ditën së përfundimit të rezervareve në Baqec.

Në ditët e fundit të muajit Maj janë përfunduar pothuajse të gjitha punët në ndëtimin e Rezervareve me vëlim  $2 \times 1500 \text{m}^3$  në Baqec dhe njëkohësisht është fillura në shtimin e sasisë së ujit nga bjeshkëa sipër ketyre rezervare ku pashihet që një pjesë e kësaj sasive të furnizojë me gravite këta rezervarë. Punë në gjurmim veq se kanë fillura dhe sasia e dheut të gjurmura është shfrytëzura për mbulimin e rezervareve. Para datës 2 Qershor 2004 ku është bërë përfundim zyrtar ketyre rezervareve janë përfunduar të gjitha punët e parapara duke përfshirë mbulim dhe rrashimin e hapësirës për rreth rezervareve montimin e komadës së pompave, montimin e klorintorit aktivizim i të gjitha pompave gjithësej 8 copë sipas fuqive të pompave nga 5.5-18.5 kë dhe duke prodhura ujë nga 55-60l/s gjithashtu është bërë edhe testim i gypave nga rezerveret kryesor deri te rezeveri në Shirokë gjithashtu është bërë edhe testim i gypave nga rezerveret kryesor deri te rezeveri në Shirokë uji ka mbri ka funksionuar mipo nuk është duke u shfrytëzura derisa të bëhen edhe disa intervenime në rrjet për ta bërë të mundur kontrollimin e sasisë së ujit në rezever në Shirokë.

Nga rezervet  $V=2 \times 1500 \text{m}^3$  në Baqec për momentin është duke u shfrytëzura vetëm fshati Sallagrazhdë.

**Qershor, 2014** \*Furnizimi me ujë Qershor-2014 Furnizimi me ujë i qytetit: Për shkak të rritjes së shpenzimeve të ujit dhe keqepërdorimeve pjesa e lartë e qytetit nuk ka furnizim 24 orë edhe pse gjatë ditës nga rezervari "Krisma" mbushet rezervari në Shirokë mirëpo është e pamundur që pikat më të larta të qytetit të kenë një furnizim të rregullt

Furnizimi me ujë i fshatrave - Ndërsa në fshatra gjendja është me e mirë me përjashtim të fshatit Studenqan dhe Samadraxhë që në javën e fundit të muajit kanë filluar reduktimet ndërsa në fshatrat e tjerë furnizimi është 24 orë.

\*Analizat e ujit Qershor-2014 - Gjatë muajit Qershor/2014 janë realizuar 15 mostra të analizave bakteriologjike dhe 15 mostra i'u kanë përgjigjë standardeve ndërsa 2 mostra nuk i'u kanë përgjigjur standardeve sipas Institutit të Shëndetit Publik

\*Rregullimi i defekteve Qershor-2014 - Në muajin Qershor/2014 është intervenuar në 40 defekte dhe atë 33 në rrjetin sekondar dhe në kyqjet individuale 2 në rrjetin kryesor 4 deblokime të kanalizimeve 1 defekt në rrjetin e kanalizimit.

\*Vazhdimi në hulumtimin e sasisë së re të ujit në pjesën sipër rezervareve të ujit të "Krimat" në Baqec.

Gjatë javës së fundit një grupë nga ekipa e operativës ka punuar vazhdimishtë në këtë punishtë në përpjekje që uji i cili është duke buruar të bëhet i mundur që nëpërmjet gypave ekzistues nga kaptazhat e vjetra të dërgohet në rezervarin e ri të "Krisma".

Nga burimi kryesor është vendosur një gypë DN-110mmPE dhe në këtë gypë janë injektuar edhe pusët për rrethë i cili gypë parashikohet që momentalishtë të lidhet me gypin e vjetër

### ARSYET QË KANË NDIKUAR NË MOSARRITJEN E OBJEKTIVAVE

1. Mos plotësimi i limitit nga ana e Inkasantëve.
2. Mospagesa e faturave nga një pjesë e Institucioneve.
3. Zhvillimi i punimeve në ndërtimin e kaptazhës së re të ujit në fshatin Studenqan ku për pasojë kemi pasur furnizim jo të mirë me ujë.
4. Pamundësia e shkyçjeve të konsumatorëve që nuk paguajnë faturat e ujit për shkak të shkaqeve objektive, siç është dëmtimi i rrugëve dhe mungesa e kapaciteteve të njësisë tonë për riparimin profesional të tyre, etj.
5. Mos zbatimi adekuat dhe me kohë i ndëshkimeve të konsumatorëve keqpërdorues të ujit nga ana e Institucioneve kompetente.

### MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS

1. Puna sa më me përgjegjësi dhe korrektësi të plotë në teren e Inkasantëve dhe ekipit të Kontrollës, në leximin e rregullt të ujmëmatësve, shpërndarjen e rregullt të faturave, hulumtimin dhe zbulimin e lidhjeve ilegale në rrjet, si dhe pasivizimin apo eliminimin nga lista e konsumatorëve të cilëve nuk iu ofrohen shërbimet tona, ose për shkaqe objektive, nuk i shfrytëzojnë këto shërbime.
2. Ngritja e vazhdueshme e nivelit të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë në punë e **shërbimit operativ** në teren, duke siguruar furnizim sa më të mirë me ujë të pijshëm dhe me parametra optimal higjieno-sanitar, riparimin efektiv dhe në kohë reale të defekteve të ndryshme që mund të shfaqen në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, ashtu që ndikon në rritjen e imazhit pozitiv të Kompanisë tek konsumatorët dhe qytetarët në përgjithësi.
3. Ngritja e vazhdueshme e nivelit të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë në punë e **shërbimit për konsumatorë**, duke siguruar trajtim sa më korrekt dhe profesional të të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, shqyrtimin e tyre dhe kthimin e përgjegjës në kohë reale, si dhe eliminimin e anomalive të ndryshme në listat e konsumatorëve, siç është faturimi i dyfishtë, mbingarkimi eventualet në muaj të caktuar, faturimi paushall i konsumatorëve që nuk dihet se pse janë regjistruar, derisa për kohë të gjatë ose nuk kanë ujë, ose nuk e shfrytëzojnë ujin e rrjetit, ashtuqë po krijohen borgje të këqija dhe asnjëherë nuk kemi një gjendje përafërsisht reale në këto lista.
4. Ngritja e një grupi Kontrolle në nivel regjional, në përbërjen e të cilit do të hynin edhe pjestarë të policisë, inspektorateve komunale e ndoshta edhe gjyqtarë dhe të cilët do të kishin përkrahjen e plotë të institucioneve, në mënyrë që menjëherë dhe në vend ngjarje të shqiptonin gjoba dhe të bënin ekzekutimin e tyre, deri në një disiplinim të plotë të konsumatorëve keqpërdorues të ujit dhe të stabilizimit eventualet të gjendjes në teren.

5. Rritja e presionit ndaj Institucioneve komunale dhe bizneseve të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj Kompanisë tonë.
6. Bashkëpunimi me mediat lokale në sensibilizimin konsumatorëve në veçanti dhe opinionit publik në përgjithësi, mbi domosdoshmërinë e shfytëzimit sa më racional të ujit, si një artikull jetik për kualitetin e jetës së qytetarëve dhe ndërgjegjësimit të vazhdueshëm të tyre për obligimet që kanë ndaj Kompanisë në shfrytëzimin legal të ujit dhe pagesën e tij.
7. Bashkëpunimi me Organet udhëheqëse komunale dhe Inspektoratin në arritjen e këtyre objektivave të parashtruara në pikën 5. qoftë edhe duke e kushtëzuar pagesën e ujit me ndonjë shërbim komunal, derisa kjo të parashihet si zgjidhje e duhur dhe e nevojshme, për çka jemi në koordinim të plotë edhe me Kryetarin e Komunës, për të gjetur një zgjidhje të pranueshme.
8. Përfundimi i ndërtimit të Kaptazhës së re të ujit të burimi në Studenqan, pas hulumtimit dhe sigurimit të një sasive dukshëm më të madhe të ujit të pijes, ashtu që do të stabilizohet furnizimi si dhe do të rritet inkasimi.

• NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	TM1- 2014	TM2- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	97,310	107,678	10,368	10.65
<i>Faturimi m3</i>	47,820	53,366	5,546	11.60
<i>Faturimi nga uji €</i>	31,868.24 €	35,278.21 €	3,409.97 €	10.70
<i>Faturimi- te tjera €</i>	33.00 €	627.00 €	594.00 €	1,800.00
<i>Faturimi Total €</i>	31,901.24 €	35,905.21 €	4,003.97 €	12.55
<i>Inkasimi nga uji €</i>	26,798.20 €	31,149.71 €	4,351.51 €	16.24
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	32.98 €	476.97 €	443.99 €	1,346.24
<i>Inkasimi Total €</i>	26,831.18 €	31,626.68 €	4,795.50 €	17.87
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	1,346	1,357	11	0.82
<i>% e inkasimit</i>	84.09	88.30	4.21	5.00
<i>Shpenzimet</i>	30,244.36 €	30,344.41 €	100.05 €	0.33
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	49,490	54,312	4,822	9.74
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	50.86	50.44	-0.42	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.89	1.04	0.16	
	- 3,413.18 €	1,282.27 €	4,695.45 €	

**AKTIVITETET KRYESORE – SHËRBIMI TEKNIK:**

**Aktivitetet mujore - Njësia Dragash, TM-2 / 2014**

**Prill, 2014\*** Aktivitetet: Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këti muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh.

\*Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.

\*Aktivitetet nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto:

- 1. Kyqje në rrjet të ujësjellsit
- 3. raste në sanimin e rrjetit të Ujësjellsit,
- 11. ndrrime të ujëmatsave (1 copë 1/2; 9 copë 3/4; 1 copë 1')
- 11. montime të ujëmatsave, (1. copa 1/2; 10 copë 3/4.)
- 15. pastrime dhe kontrollime të ujëmatsave,
- 19. pastrime në rrjetin e kanalizimit
- 3. angazhime tjera të ekipit teknik.

-Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon \*Kompania duke i përfshir punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratës së përgjithëshme.

Këto aktivitete e përfshijnë zonën e veprimit në Dragash, në fshatin Pllavë, në fshatin Shajne dhe në fshatin Brezne.

\*Prodhimi i ujit: Në këtë muaj janë prodhuar 34.203.m<sup>3</sup>.ujë dhe kjo sasi ka kushtzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

\*Humbjet e ujit: Humbjet e ujit këtë muaj arrijnë deri në 50 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellsit.

**Maj, 2014** \*Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këtij muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh. Është bërë edhe pastrimi i kaugullatorit.

\*Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.

\*Aktivitete nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto:

\*1. Kyqje në rrjet të ujësjellsit, \*5. raste në sanimin e rrjetit të Ujësjellsit, \* 6. ndrrime të ujëmatsave (6 copë 3/4.), \*9. montime të ujëmatsave, (1. copa 1/2; 8 copë 3/4.), \* 4. pastrime dhe kontrollime të ujëmatsave, \*4. angazhime tjera të ekipit teknik.

\*Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon Kompania duke i përfshir punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratës së përgjithëshme.

\*Këto aktivitete e përfshijnë zonën e veprimit në Dragash, në fshatin Pllavë, në fshatin Shajne dhe në fshatin Brezne.

\*Prodhimi i ujit: Në këtë muaj janë prodhuar 36.175.m<sup>3</sup>.ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

\*Humbjet e ujit: Humbjet e ujit këtë muaj arrijnë deri në 50 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellsit.

**Qershor, 2014.** \*Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këtij muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh. Është bërë edhe pastrimi i kaugullatorit.

Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.

Aktivitete nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto:

-2. Kyqje në rrjet të ujësjellsit

-2. raste në sanimin e rrjetit të Ujësjellsit,

-2. ndrrime të ujëmatsave (2 copë 3/4.)

-6. montime të ujëmatsave, (1. copë 1'; 5 copë 3/4.)

-4. pastrime dhe kontrollime të ujëmatsave,

-4. angazhime tjera të ekipit teknik.

-Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon Kompania duke i përfshir punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratës së përgjithëshme.

Këto aktivitete e përfshijnë zonën e veprimit në Dragash, në fshatin Pllavë, në fshatin Shajne dhe në fshatin Brezne.

-Prodhimi i ujit: Në këtë muaj janë prodhuar 37.300.m<sup>3</sup>.ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

-Humbjet e ujit: këtë muaj arrijnë deri në 50 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellsit.

#### • PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË MOS ARRITJEN E OBJEKTIVAVE:

Objektivat në përgjithsi janë arritur jan pajisur konsumatorët me ujëmatës pra kemi një vetdisim të popullatës për vendosjen e ujëmatësve dhe heqjen e paushallit, pra janë vendosur 7 ujëmatës.

- Faturimi ka qenë më i mirë se në tremujorin e parë sepse faturimi është në lidhshmëri me prodhimin e ujit. Aktivitetet financiare janë realizuar sipas rregulloreve dhe performanca në njësi ka qenë pozitive.

Inkasimi ka pasur rritje sepse në tre mujorin e dyte vijne konsumatorët nga gurbeti. Numri i konsumatorëve është stabil ,por shenon ngritje te leta.

- Shpenzimet në tremujor e dyte janë ulur sepse kemi rritur kudesin ndaj krijimit te shpenzimeve(ulje te shpenzimeve te karburantet).

### **MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS**

-Angazhimet shtesë te ekipes se kontrolles per te verifikuar keqpërdorusit si dhe angazhime më të mëdha te ekipes së detektimit për të gjetur rrjedhjet, duke ulur humbjet e UPF.

-Shërbimi sa më i mirë dhe professional për qytetarët, dhe zgjidhja me korrektësi e ankesave dhe kërkesave të tyre.

-Vetëdisimi i qytetarve për shfrytzimin e drejt te ujit të pijes, duke mos e keqpërdorur, njeherit të jenë të pëgjegjshëm në pagesa ndaj sherbimit të Kompanisë.

-Inkasantët të kembengulin që gjithësesi tek konsumatorët të paguajnë së paku faturat mujore.

-Bashkëpunimi dhe kordinimi institucionet Komunale.

-Aplikimi i ç'kyçjeve individuale ndaj konsumatorëve të papëgjegjshëm,.

-Rritja e nivelit të aktivitetit në informimin

-Të zgjidhet institucionalisht problemi i konsumatorëve të Rasteve sociale.



## NJ.P - MALISHEVË

MUAJI	TM1- 2014	TM2- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<b>Prodhimi m3</b>	336,952	336,322	-630	-0.19
<b>Faturimi m3</b>	161,792	134,048	-27,744	-17.15
<b>Faturimi nga uji €</b>	86,693.91 €	78,067.77 €	- 8,626.14 €	-9.95
<b>Faturimi- te tjera €</b>	4,823.76 €	8,348.10 €	3,524.34 €	73.06
<b>Faturimi Total €</b>	91,517.67 €	86,415.87 €	- 5,101.80 €	-5.57
<b>Inkasimi nga uji €</b>	52,112.53 €	44,548.78 €	- 7,563.75 €	-14.51
<b>Inkasimi - te tjera €</b>	4,995.93 €	4,950.45 €	- 45.48 €	-0.91
<b>Inkasimi Total €</b>	57,108.46 €	49,499.23 €	- 7,609.23 €	-13.32
<b>Nr. i Konsumatorëve</b>	3,644	3,682	38	1.04
<b>% e inkasimit</b>	60.11	57.06	-3.05	-5.07
<b>Shpenzimet</b>	71,388.07 €	59,831.81 €	- 11,556.26 €	-16.19
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	175,160	202,274	27,114	15.48
<b>Uji I pafaturuar ne %</b>	51.98	60.14	8.16	
<b>Mbulimi operativ</b>	0.80	0.83	0.03	
	- 14,279.61 €	- 10,332.58 €	3,947.03 €	

### AKTIVITETET TM2/2014 –MALISHEVË

#### Aktivitetet mujor - Njësia Malishevë – TM-2 / 2014

**Prill, 2014** \* Furnizimi me ujë gjatë muajit mars/2014 , ka qenë i mirë dhe pa reduktime.Fillimi i hapjes se bunarve ne senik,ku nje bunar eshte hapur me thellsi 130 m' dhe puna po vazhdon.

\* Gjatë muajit Mars /2014 janë realizuar 5 mostra të analizave bakteriologjike dhe 5 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve të gjitha iu kanë përgjigjur standardeve.

\*Aktivitete lobimi -Kontaktet me perfaqesust e IRD-së,Drejtorin e Urbanizmit,Perfaqesuesin e fshatit Drenoc për prezantimin e projektit ideor te Ujësiellsit ne fshatin Drenoc,Kntakte me Drejtorte e bordit te Komunes.

\*Rregullimi i defekteve – Rrjeti primar 14 defekte, Rrjeti sekondar 9 defekte, Debllokimi i kanalizimeve 2 ndërhyrje dhe 0.7 km kanal të pastruar, Ankesat teknike -2, Ankesat komerciale -0, Njoftime për shkyqje - 5,shkyqje për mospagesë -12, Kyqje ilegale - 12, Shkyqje të kyqjeve ilegale -12, Rikyqje - 12, Kyqje të reja – 23, Amvisëri =16, Lokale = 7

- Procesverbale të shkyqjeve= 12, Verifikim të ujëmatësave -215, Inkasimi nga kontrolla -2.411.46€, Ujëmatësa të ndërruar -3, Ujëmatësa të montuar -8.

**Maj, 2014** \*Furnizimi me ujë gjatë muajit Maj/2014 , ka qenë i mirë dhe pa reduktime.

\*Analizat e ujit – Gjatë muajit Maj /2014 janë realizuar 5 mostra të analizave bakteriologjike dhe 5 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve të gjitha iu kanë përgjigjur standardeve.

\*Aktivitete lobimi - Kontaktet me perfaqësuesin e Drejtorit e Sherbimeve Publike, Takim me perfaqësuesin e fshatit Drenoc ku edhe ka filluar realizimi i projektit ne ketë fshatë nga investitori IRD-së K,K.Malishevë dhe HRJ .

\*Kontakte me Drejtorte e bordit te Komunes , si dhe prezantimi i raportit mujor.

\*Rregullimi i defekteve – Maj/ 2014

\*Rrjeti primar 11 defekte \*Rrjeti sekondar 13 defekte \*Debllokimi i kanalizimeve 4 ndërhyrje dhe 2.8 km kanal të pastruar, \*Ankesat komerciale -6, \*Njoftime për shkyqje -38, \*shkyqje për mospagesë -3, \*Kyqje të reja – 3, \*Amvisëri -3, \*Procesverbale të shkyqjeve -3, \*Verifikim të ujëmatësave -506, \*Inkasimi nga kontrolla – 1139.64 €, \*Ujëmatësa të ndërruar -8, \*Ujëmatësa të montuar -6 .

**Qershor,2014** \*Furnizimi me ujë – Qershor / 2014 Furnizimi me ujë gjatë muajit Qershor /2014 , ka qenë i mirë dhe pa reduktime.

\*Analizat e ujit – Qershor / 2014- Gjatë muajit Qershor /2014 janë realizuar 5 mostra të analizave bakteriologjike dhe 5 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve të gjitha iu kanë përgjigjur standardeve.

Aktivitete lobimi

\*Kontaktet e rregullta me perfaqësuesit Komunal: Kryetarin Begaj, drejtorët e Sh.publike dhe ate të Urbanizmit me të cilët koordinojmë aktivitetet për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me ujin.

\*Përcjellja e rregullt e ekzekutimit të punimeve në ujsjellësin e fshatit Drenoc ku janë duke vazhduar punimet sipas planit dinamik.

\*Marrëveshja në mes të Kryetarit të Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj ,Përfaqësuesit të IRD-së z. Azem Kastrati dhe Udhëheqësit të Njesisë –Malishevë z. Njazi Bytyçi për realizimin e rrjetit furnizues L=1.4km fi 160 mm,për ujësjellësin e fshatit Drenoc nga gypi kryesor ne Malishevë në vlerë prej 35.000 €.(sipas kërkesës së U.NJ.M).

\*Hapja e pusetave në fsh. Bajë,Lumishtë,Mirushë dhe qytezën e Malishevës = 85 puseta me punëtorët sezonal të M.P.M.S (50 punëtor).

Rregullimi i defekteve –Qershor/ 2014: Rrjeti primar 12 defekte, Rrjeti sekondar 15 defekte, Debllokimi i kanalizimeve 2 ndërhyrje dhe 1.7 km kanal të pastruar, Ankesat komerciale -4, Njoftime për shkyqje -75, shkyqje për mospagesë -3, Kyqje ilegale - 2, Shkyqje të kyqjeve ilegale -2, Kyqje të reja – 34, Amvisëri -28, Lokale -6, Procesverbale të shkyqjeve-5, Verifikim të ujëmatësave -337, Inkasimi nga kontrolla – 1356.04 €, Ujëmatësa të ndërruar -18, Ujëmatësa të montuar -12 .

\*Aktivitetet e kontrollës-Qershor/2014:Verifikimi i ujëmatesave-337, Njoftime per shkyqje-75, Shkyqje per mospagese-3, Proqesverbale te shkyqjeve-5, Shkyqje te k. ilegale-2, Procesverbale te shk. Ilegale-2 , Inkasimi nga kontrolla-1.356.04 Euro.

#### **PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË MOS ARRITJEN E OBJEKTIVAVE:**

\*Rënja e faturimit në m3 –27.724m3 –pershkak te leximit jo te sakte te ujematesave.

\*Faturimet tjera –kemi rritje per 3.524.34€ ne krahasim me TM1-shkak rritja e aktiviteve.

\*Inkasimi në euro është për 7.563.75 € më i ulët se TM1 -

Shkaqet-Shkyqja e pa mjaftueshme e konsumatorëve me borgje te medha.

\*Mungesa e një inkasanti pas largimit te inkasantit Fazli Kastrati si dhe mosrealizimit të normës së inkasimit nga inkasanti :1. Veli Begaj,

\*Mospagesa e faturave nga institucionet ,për tre muaj në vlerë prej :15.642€ , ku për periudhën Janar/Qershor /2014 kanë paguar vetëm për tre muaj.

\*Shpenzimet e larta të Energjisë elektrike:Tarifa dimërore në TM1, Rritja e nevojave për ujë në TM2, I gjithë sistemi i furnizimit është me pompa, Defektet e shumëta në rrjet (79),Rriten humbjet e ujit si dhe duhet pjesë montuese, Rritja e ujit të pafaturuar (8.16%) –pasojë e rrjedhjeve te ujit nga defektet ne rrjet ,pore edhe nga mosleximi i ujematesave, Shkalla e lartë e papunësisë ,dhe numri i madhë i konsumatorëve-raste sociale, Vështirësitë e shumëta në teren për ti shkyqur konsumatorët me borgje,

**AKTIVITETET E KONTROLLS-TM2/2014:** Verifikimi i ujematesave = 1027, Njoftime per shkyqje = 128, Shkyqje per mospagese = 10, Proqesverbale te shkyqjeve per mospagese = 10, Shkyqje te k. ilegale = 14, Procesverbale te shk. Ilegale = 14, Rikyqje te konsumatoreve = 12, Kyqje te reja = 38 ( A=31; L=7), Inkasimi nga kontrolla = 3.495.68 Euro

#### **MASAT E PROPOZUARA:**

\*Ulja e shpenzimeve operative ,si dhe të energjisë elektrike –duke ndalur pompat 4 orë gjatë ditës kur tarifa është e lartë,

\*Shkyqja e të gjithë konsumatorëve që nuk paguajnë së paku faturën mujore,

\*Paisja e të gjithë konsumatorëve me ujëmatës (100%),

\*Leximi i saktë i ujëmatësave,

\*Kushtëzimi nga Komuna –lëshimi i dokumenteve me pagesën e ujit,

\*Bashkëpunim më i mirë me PK (policinë e kosovës) dhe inspektorët komunal,

\*Dërgimi i lëndëve në gjykatë për k.ilegale dhe konsumatorët me borgje të mëdha,

\*Mbulimi i rasteve sociale nga Qeveria,

\*Evitimi me kohë i defekteve në rrjet, zbulimi i kyqjeve ilegale, Largimi nga puna i inkasantëve të cilët brenda 6 muajve nuk e realizojnë normën e paraparë,

• **HIDROREGJIONI JUGOR -TM1 -TM2 -2014**

MUAJI	TM1- 2014	TM2- 2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<b>Prodhimi m3</b>	4,196,017	4,290,122	94,105	2.24
<b>Prodhimi - l/sec</b>	540	552	12.1	2.24
<b>Faturimi m3</b>	1,654,556	1,738,033	83,477	5.05
<b>Faturimi l/sec</b>	213	224	11	5.05
<b>Faturimi nga uji €</b>	917,570.43 €	963,067.33 €	45,496.90 €	4.96
<b>Faturimi- te tjera €</b>	19,070.02 €	23,818.88 €	4,748.86 €	24.90
<b>Faturimi Total €</b>	936,640.45 €	986,886.21 €	50,245.76 €	5.36
<b>Inkasimi nga uji €</b>	727,122.12 €	660,402.75 €	- 66,719.37 €	(9.18)
<b>Inkasimi - te tjera €</b>	15,642.25 €	23,827.89 €	8,185.64 €	52.33
<b>Inkasimi Total €</b>	742,764.37 €	684,230.64 €	- 58,533.73 €	(7.88)
<b>Nr. i Konsumatorëve</b>	39,624	40,053	429	1.08
<b>% e inkasimit</b>	79.24	68.57	-10.67	(13.47)
<b>Shpenzimet</b>	797,920.78 €	713,925.81 €	- 83,994.97 €	(10.53)
<b>Paqa bruto</b>	417,311.46 €	427,954.17 €	10,642.71 €	2.55
<b>Mirmba. dhe riparimet</b>	51,904.23 €	62,354.18 €	10,449.95 €	20.13
<b>Rryma elektrike</b>	252,783.48 €	145,780.41 €	- 107,003.07 €	(42.33)
<b>Shpenzi. e derivateve</b>	25,772.91 €	23,761.49 €	- 2,011.42 €	(7.80)
<b>Kemikalet</b>	1,638.28 €	1,986.20 €	347.92 €	21.24
<b>Shpenzi. tera operat.</b>	48,510.42 €	52,089.36 €	3,578.94 €	7.38
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	2,541,461	2,552,089	10,628	0.42
<b>Uji I pafaturuar ne %</b>	60.57	59.49	-1.08	
<b>Uji I pafaturuar l/sec</b>	326.83	328.20	1.37	0.42
<b>Mbulimi operativ</b>	0.93	0.96	0.03	
	- 55,156.41 €	- 29,695.17 €	25,461.24 €	

**AKTIVITETET KRYESORE:**

\*Gjatë TM-2 2014 ne kompaninë e “Hidroregjionit Jugor” ka pasur rritje të prodhimit prej 94,105 m<sup>3</sup> ose 2.24 %, kjo rritje të prodhimit është e lidhur me nevojat e konsumatorëve për të shfrytëzuar ujin. Gjendje e furnizimit me ujë gjatë TM-2 ka qenë stabile në të gjitha njësitë operuese.

\*Raportet tregojnë që UPF në nivel regional për TM-2 është 59.49 % me rënie të UPF prej -1.08 % nga tremujori paraprak të vitit 2014.

**PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË MOS ARRITJEN E OBJEKTIVAVE:**

\* Investimeve të vazhdueshme.

\* Humbjet e ujit

\*Për mos arritjen e objektivave, janë numri i 704 defekteve ne sistemin e ujesjellesit dhe të kanalizimit, për shkak te rrjetit të vjetërsuar.

**MASAT E PROPOZUARA:**

\*Angazhimet shtesë te ekipes se kontrolles per te verifikuar keqepërdorusit si dhe angazhime më të mëdha te ekipes së detektimit për të gjetur rrjedhjet, duke ulur humbjet e UPF.

\*Shërbimi sa më i mirë dhe professional për qytetarët, dhe zgjidhja me korrektësi e ankesave dhe kërkesave të tyre.

\*Rritja e nivelit të aktivitetit në informimin

**AKTIVITETI I SHËRBIMIT FINANCIAR**

Kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme dhe të arkëtueshme;

Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;

Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, me apo pa kontratë

Kontrollimi dhe nënshkrimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;

Rifreskimi i shënimeve; të pagueshmet dhe të arkëtueshmet

Kontrollimi i borxheve të konsumatoreve dhe borxhet ndaj furnitorëve, barazimi i funitoreve si dhe pagesa ndaj tyre.

Pregatitja e raporteve mujore; faturimi, inkasimi dhe shpenzimet; ZRRUK, etj

Takime me kryeshefin lidhur me performancën e mujit të kaluar të kompanisë si dhe takime me menaxherët e njësisë.

Raportet ditore me shërbimet brenda departamentit të financave si dhe brenda ndërmarrjes;

Takim me menaxhmentin e kompanisë, me shërbimet përkatëse, etj;

Angazhim i departamentit të financave është në vazhdimësi në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të saj, në ofrimin e shërbimeve për sektoret tjerë të kompanisë në menyrë që të permirsohet dhe performanca e kompanisë.

**Arsyeshmëria e shpenzimeve**

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e II-të të 2014, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të parë të vitit, kanë qenë më të ulëta, kjo ka ndikuar që edhe mbulueshmëria të jetë më e lartë. Më poshtë do t'i cekim disa nga arsyet dhe ndryshimet në disa nga pozicionet kryesore të shpenzimeve.

Nëse shikojmë shpenzimet në pozicionin e pagave, ato janë rritur në një përqindje të vogël të tyre, duke ditur se zona operuese po rritet dhe shërbimet ndaj konsumatorëve po bëhen më të mira, gjithashtu edhe numri i punëtorëve për këtë tre mujor është shtuar.

Te shpenzimet e energjisë elektrike kemi rënie të tyre, edhe pse kemi shtim të pompave të në burimet e reja që kompania ka hapur, shpenzimet e energjisë elektrike janë më të ulta sepse në tremujorin e dytë të vitit faturohemi me tarifën verore.

Te pozicioni i derivateve nuk kemi ndonjë ndryshim që do të ndikonte në shpenzimet totale, pra në këtë tremujor kemi një rënie të vogël të shpenzimeve për derivate.

Ndërsa te mirëmbajtja, kemi një rritje të shpenzimeve, pra nevoja për intervenime në rrjet dhe mirëmbajtje të pompave ka qenë më e lartë në këtë tre mujor në krahasim me tremujorin e fundit.

Investimet tona janë duke vazhduar në gjetjen e burimeve të ujit, lëshimin e rezervuarve të rinjë të ujit, shtrirjen e rrjetit të ri të gypave të ujësjellësit, intervenimeve në rrjetin ekzistues, me ndihemn e donacioneve nga qeveria dhe komunat, si dhe nga investimet tona vetanake, duke ditur misionin tonë, në ofrimin e shërbimeve të gjithë qytetarëve në zonen ku ne operojmë.

Edhe pse angazhimi jonë në inkasim vazhdon me një përkushtim të shtuar, në këtë tremujor, në krahasim me tremujorin e parë, kemi një rënie të inkasimit. Shkak për këtë është se, inkasimi tek kategoria e institucioneve ka rënë, për asryse të mos alokimit të buxhetit të tyre, gjë që kjo ka ndikuar direkt në rënie të inkasimit.

#### AKTIVITETET KRYESORE:

- Në fund të TM2 në njësin e Prizrenit janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 40,091 fatura, prej tyre: 34.708 amvisëri , 4.767 biznese dhe 616 institucione. Në TM2 në krahasim me TM1 kemi 467 fatura të lëshuara me tepër. Një numër i këtyre konsumatorëve është si rezultat i pëlqimeve për kyqje (94 konsumatorë) ndërsa pjesa tjetër është rezultat i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës (373 konsumatorë).
- Gjatë muajit TM2 janë faturuar 1,738,987 m<sup>3</sup> ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1,438,987m<sup>3</sup>, biznese: 122,381 m<sup>3</sup> dhe institucione 175,915 m<sup>3</sup> ujë. Nëse e krahasojm me TM1 kemi një faturim më të madh prej 83,477 m<sup>3</sup>. Rritje të sasisë së faturimit në krahasim me TM1 ka ndodh te të tri kategoritë e konsumatorëve: (te amvisëria +71,104 m<sup>3</sup>, te bizneset +15,784 m<sup>3</sup> dhe institucionet – 3,939 m<sup>3</sup>).

Sipas njësive kemi këtë gjendje (Prizreni + 95,658 m<sup>3</sup>, Malisheva - 27,744 m<sup>3</sup>, Suhareka + 10,017 m<sup>3</sup>, Dragashi + 5,546 m<sup>3</sup>,)

#### TM2 (prill,maj, qershor)

1	Uji i Faturuar	Njesia	1,738,033
2	Konsumatorët Shtëpiak	m3	1,438,987
3	Konsumatorët Komercial-Industrial	m3	122,381
4	Konsumatorët Institucional	m3	175,915

- Edhe pse inkasimi në kategorin e bizneseve dhe amvisërive në TM2 ka qenë përfaërsisht i njëjtë në krahasim me TM1. Në TM2 kemi të inkasuar më pak 66,719.37 euro. Ky ndryshim në inkasim është rezultat kryesisht të Spitalit Rajonal” Daut Mustafa” , zyrtarët e spitalit në TM1 kanë paguar 65.909,45 euro (58,310.87 euro ne janar dhe 7,598.58 në muajin shkurt), ndërsa në TM2 kanë paguar vetëm 9,476.47 euro që dmth në TM2 vetëm të ky konsumator kemi 56,432.98 euro më pak të inkasuara.
- Sipas njësive kemi këtë gjendje (Prizreni - 63,813.96 €, Malisheva - 7,609.23 €, Suhareka + 773.21 € , Dragashi + 4,351.51 €)
- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe ç'kyçjes në Njësia Operative në Gjatë këtij muaji në njësia e Prizrenit nga ekipet e kontrollës janë vizitu 4,181 konsumatorë, janë regjistru 404 konsumatorë ilegal të cilët bazuar në procedurat e mbrendshme janë legalizuar ndërsa janë shkyq 30 konsumatorë për lidhje ilegale dhe mospagesë .Konsumatorët të cilët janë hasur me lidhje ilegale janë shkyq menjëher.

#### RAPORT I EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES Prill-Qershor 2014

Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
Prizren	228	9	5	1,896	26,586.70 €
Suharekë	163	4	11	1,258	8,354.00 €
Malishevë	12	17	14	1,027	3,495.68 €
Dragash	1	0	0	0	0.00 €
KRU "Hidroregjioni Jugor"	404	30	30	4181	38,436.38 €

#### • PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË MOS ARRITJEN E OBJEKTIVAVE:

- Mospagesat e rregullta e rregullta mujore nga konsumatorët e mëdhëj (institucionet)
- Pamundësit teknike në realizimin e shkyqjeve të konsumatorët që jetojnë në ndërtesa kolektive(banesa)
- Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellsit :
  5. Te konsumatorët e amvisërisë- gjendja e rënde ekonomike
  6. Te bizneset – pamundësia e pagesave rrjedhëse e cila vjen nga rënia e punës në biznese.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për të paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mosfurnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktime) po ndikojnë në inkasim të shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit.

- **MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS**

- Stimulimi i inkasantëve në nënshkrimin e kontratave me konsumatorë në teren për riprogramimin e borxheve mbi 200 euro.
- Ndryshimi i faturës mujore për shërbimet e ujësjellsit dhe kanalizimit, ku nga muaji korrik e tutje konsumatorët mund të paguajn me KOS-GIRO te secila bankë komerciale.
- Vazhdimësia e punës së ekipeve të kontrollit për së bashku me operativen për shkyqjen e konsumatorve borgjlinj të mëdhej mbi =300,00 euro, të cilët nuk bëjnë pagesa dhe riprogramim të borxhit..
- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shumën të lartë të borgjëve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për riprogramimin e borgjëve në mënyrë që këta konsumatorë të futen në sistemin të pagesave të fakturave
- Konsumatorët të cilët shkyqen nga rrjeti për mos pagesë nuk do të rikyqen pa i paguar së paku 30% të borgjit total .
- Marrja e masave ligjore sipas Zyres Rregullative për shkyqjen e konsumatorve për mos pagesë.
- Rritja e efikasitetit të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyqjes.
- Përdorimi i padisë së konsumatorve në gjykatë për mos pagesë.
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borgjeve aty ku kanë vështirësi inkasantet.

## VI. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM.

Raporti në vijim paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të ndërmarra të auditorit të brendshëm, për periudhën kohore janar – qershor 2014.

Edhe pse për të gjitha aktivitetet e ndërmarra, ekzistojnë raporte të veçanta të përgatitura me shkrim, të cilat dhe janë raportuar dhe shqyrtuar në takimet me komisionin e auditimit, megjithatë për qëllime raportimi, përmes këtij raporti paraqitet një kronologji e punëve dhe aktiviteteve të realizuara.

- Fillimisht, gjatë kësaj periudhe është përgatitur raporti vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin 2013, ku janë paraqitur të gjitha auditimet e realizuara gjatë vitit të kaluar. Në raport, në formë të përgjithësuar, janë prezentuar rekomandimet e dhëna si dhe shkalla e implementimit të tyre.
- Në pajtim me legjislacionin në fuqi, është përgatitur dhe është aprovuar nga komisioni i auditimit:
  - plani strategjik i punës së auditorit të brendshëm për periudhën 2014-2016 dhe
  - plani vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin 2014.

Në pajtim me planin vjetor të paraparë, por edhe me kërkesë të komisionit të auditimit, janë kryer auditime në disa subjekte audituese, sikurse në: departamentin e financave, departamentin teknik dhe në shërbimin për raportim dhe plan biznes.

- Fusha e auditimit ka qenë:
  - menaxhimi i procesit të pagave bazë të punonjësve,



- menaxhimi i të hyrave – faturimit dhe inkasimit,
  - menaxhimi i procesit të raportimeve në kompani,
  - menaxhimi i procesit të realizimit të shpenzimeve,
  - menaxhimi i procesit të dhënies së pëlqimeve dhe lejeve,
  - menaxhimi i planit vjetor të biznesit,
- Pas përfundimit të auditimeve dhe testimeve të nevojshme, në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm është bërë:
    - përgatitja e draftraporteve për të gjitha auditimet e lartëpërmendura,
    - mbajtja e takimeve me subjektet e audituara, si dhe diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe
    - përgatitja e raporteve finale (përveq draft raportit të auditimit të planit vjetor të biznesit).
- Gjatë kësaj periudhe, përpos auditimeve të lartëpërmendura, me kërkesë të komisionit të auditimit dhe me kërkesë të komitetit për hulumtime dhe teknologji, janë kryer edhe dy auditime, për të cilat janë përgatitur raporte, dhe janë raportuar në Komision të Auditimit, si dhe në Bordin e Drejtorëve.  
Fjala është për auditimet ku në fushëveprim kanë pasur:
    - menaxhimin e procesit për realizimin e projektit të ashtuquajtur “Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujrave të Zeza” që do të ndërtohet në Prizren, dhe
    - menaxhimin e procesit të prokurimit për projektin “Punimi i projektit për ndërtimin e pendës akumuluese në Manastiricë”.
- Gjithashtu përveq aktiviteteve të lartëpërmendura gjatë kësaj periudhe, kam qenë i angazhuar në disa aktivitete tjera, ku si më kryesoret mund të përmenden:
    - Asistimi i rregullt me ekipin e auditorëve të jashtëm, të cilët kanë kryer auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2013.
    - Me rastin e pranimit të draft raportit të dërguar nga ana e Zyres së Auditorit të Përgjithshëm, lidhur me auditimin e procesit të kompensimit të Bordeve të Drejtorëve për periudhën 2009-2012, në bashkëpunim me kolegë të shërbimeve tjera kemi bërë shqyrtimin, diskutimin dhe përgatitjen e komenteve në lidhje me konstatimet të dala nga ky raport.
- Më duhet të theksoj se pas dërgimit të komenteve ende ne si kompani nuk kemi marrë kurrfarë përgjigje.

**VII. RAPORT I AKTIVITETIT TE PROKURIMIT  
PROCEDURAT E PROKURIMIT ME VLERA TE VOGLA DHE TE MESME**

Nr.	Titulli i Kontrates	Numeri i prokurimit	Cmimi i Kontrates	Emir i O.E
1	Furnizim me jakne	HJ/14/001/136	8,100.00	NTP "PRINTEKS"
2	Furnizim me pomp ate ujit	HJ/14/005/136	9,900.00	NTP "TAF AJ-CO"
3	Furnizim me elektromotor	HJ/14/010/136	8,270.00	NTP "TAF AJ-CO"
4	Furnizim me instalim I serverit	HJ/14/008/136	7,071.53	Asseco South Eastern Europe
5	Riparimi dhe mirmbajtja e auromjeteve	HJ/14/013/136	4,203.50	NTSH "KRASNIQI"
6	Furnizim me pjese te ujesjellesit	HJ/14/012/136	7,546.70	DPT "ENDRITI"
7	Ngjyrosja e objektit	HJ/14/011/136	2,633.52	NTP "AGI"
8	Furnizim me pompa zhytесе dhe electromotor per pompa	HJ/14/017/136	9,795.00	NTP "LINDA"
9	Furnizim me kepuce	HJ/14/016/136	4,968.00	SHPL "SOLID"

Nr.	Titulli i Kontrates	Numeri i prokurimit	Cmimi i Kontrates	Emir i O.E
1	Hulumtimi i ujit te pijes te Krismat e Mushtishtit dhe rezervuari V=1000m <sup>3</sup>	HJ/14/007/521	216,833.80	NSHN "BURIMI"
2	Furnizim me pompa te ujit te pijshem	HJ/14/009/121	30,541	NTP "TAF AJ-CO"
3	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit ne rr. "Fetah Gega" dhe "Kadri Nesho" (faza II shpimi I puseve tek livadhet)	HJ/14/006/521	94,700.00	NSHN "BURIMI"
4	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit ne rr. "Fetah Gega" dhe "Kadri Nesho"	HJ/14/004/521	49,633.56	NPT "Fanaj Inxhinering"
5	Izolimi I Bazenit	HJ/14/003/536	9,660.00	SHPK "Capital Group"
6	Furnizim me rere	HJ/14/002/121	Deri ne 125,000.00	NTSH "SEDTOURS"

**STRUKTURA ORGANIZATIVE**  
**KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN**

